



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

PROGRAMI – STUDIMET PASDIPLOMIKE

“MBROJTJA JURIDIKE E POSEDIMIT NË REPUBLIKËN E KOSOVËS ME THEKS
TË VEÇANTË NË TERRITORIN E GJYKATËS THEMELORE FERIZAJ DEGA NË
KAÇANIK GJATË PERIUDHËS 2013 -2019”

Mentori:

Doc. dr. Artë Selmani-Bakiu

Kandidati:

Burim Çaka

**Tetovë
Prill 2020**

MIRËNJOHJE

Punimet e një rëndësie apo rangu të tillë padyshim që nuk mbajn vetëm vulën e përkushtimit të kandidatit, në këtë rast mua, por sigurisht edhe shumë personave tjerë të cilët kontribuan në ofrimin e ndihmës për këtë punim.

Fillimisht ndihma e pakontestueshme në ofrimin e mundësisë në hulumtimin e statistikave i takon stafit të Gjykatës Themelore në Ferizaj - Dega në Kaçanik të cilët çdoherë ishin të gatshëm tu përgjigjen kërkesave të mia dhe të cilët më siguruan të gjitha lëndët e vitit 2013-2019 dhe materialin e nevojshëm i cili do ti shërbente këtij punimi.

I jam mirënjohës dhe falenderues Mentores time Doc. dr. Arta Selmani-Bakui dhe jo vetëm në ndihmën e ofruar dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm por edhe për këshillat e dhëna në përgjithësi.

Falenderoj mbi të gjitha familjen time e cila gjithmonë më ka motivuar në përgjithësi dhe në veçanti gjatë kohës së punimit të temës së masterit duke pas parasysh që punimi i kësaj teme do një përkushtim dhe energji më të veçantë.

PASQYRA E PËRMBAJTJES

Pasqyra e përmbajtjes.....	3
Abstrakti.....	7
Hyrje.....	8
 KAPITULLI I.....	 9
1. POSEDIMI.....	9
1.1. Historiku i posedimit sipas të drejtës romake.....	9
1.2. Historiku i posedimit në Republikën e Kosovës.....	10
1.3. Nocioni i posedimit	12
1.4. Objekti i posedimit.....	13
1.5. Posedimi i të drejtave.....	14
1.6. Elementet e posedimit.....	15
1.7. Llojet e posedimit.....	15
1.7.1. Posedimi i drejtëpërdrejtë dhe posedimi tërthorë (indirect).....	15
1.7.2. Posedimi ligjor dhe joligjor.....	16
1.7.3. Posedimi i vërtetë dhe jo i vërtetë.....	16
1.7.4. Posedimi me mirëbesim dhe me keqbesim.....	16
1.7.5. Poseduesi i pavarur dhe bashkëposedimi.....	17
1.7.6. Posedimi pronësor.....	18
2. FITIMI DHE HUMBJA E POSEDIMIT.....	18
2.1. Fitimi i posedimit.....	18
2.1.1. Mënyrat e fitimit të posedimit.....	20
2.1.1.a. Fitimi i posedimit në mënyrë origjinere	20

2.1.1.a.1. Posedimi i fituar në mënyrë origjinere - në bazë të ligjit.....	20
2.1.1.a.2. Posedimi i fituar në mënyrë origjinere - Pushtimi.....	20
2.1.1.b. Fitimi i posedimit në mënyrë derivative.....	20
2.1.1.b.1. Fitimi i posedimit në mënyrë derivative - veprimi juridik.....	21
2.1.1.b.2. Fitimi i posedimit në mënyrë derivative - Akti administrativ.....	21
2.1.1.b.3. Fitimi i posedimit në mënyrë derivative - Trashëgimia.....	21
2.2. Humbja (shuarja) e posedimit	21
2.2.1. Humbja e posedimit me mungesën e corpus-it dhe animus-it.....	22
2.2.2 Humbja e posedimit me mungesën e corpus-it.....	22
2.2.3 Humbja e posedimit me anë të përfaqësuesit.....	22
 KAPITULLI II.....	23
1. Mbrojtja e posedimit.....	23
1.2. Kompetenca.....	23
1.3. Llojet e padive për mbrojtjen e posedimit.....	24
1.3.1. Padia për pengim posedimin.....	24
1.3.1.1. Pengimi i posedimit.....	24
1.3.1.2. Kundër kujt mund të ngrihet padia për pushimin e pengimit të posedimit ...	25
1.3.1.3. Objekti i padisë së pushimit të pengimit të posedimit.....	26
1.3.2. Padia për rivendosjen në posedim (rikthimin në posedim).....	26
1.3.2.1. Zhveshja e paligjshme e posedimit.....	27
1.3.2.2. Kush mund të ngrejë padinë për rivendosjen në posedimit.....	28
1.3.2.2. Kundër kujt mund të ngrihet padia për rivendosjen e posedimit	28
1.3.2.4. Objekti i padisë për rivendosjen në posedim.....	28
1.4. Afatet për paraqitjen e padive.....	29
1.5. Barra e provës në paditë posedimore dhe prezumimet ligjore.....	29
1.6. Prezumimet që i referohen corpusit	29
1.7. Prezumimi që i referohet animusit.....	30
1.8. Shpërblimi i dëmit në gjykimet posedimore.....	30

1.9. Dallimi i padisë posedimore nga padia e rivendikimit dhe padia negatore.....	31
1.10. Natyra e kontesteve.....	32
1.11. Objekti i kontesteve.....	32
1.12. Vendimet.....	33
1.13. Masat siguruese.....	34
1.14. Mjetet juridike.....	34
1.15. Ekzekutimi i vendimeve.....	34
1.16. Krahësimi i mbrojtjes së posedimit në mes të Republikës së Kosovës me Republikën e Shqipërisë dhe Republikën e Maqedonisë Veriore.....	35
 KAPITULLI III.....	 37
1. Juridiksioni i Gjykatës Themlore Ferizaj dega në Kaçanik.....	37
2. Të dhënat statistikore.....	37
2.1. Lëndët e paraqitura në Gjykatën Themlore Ferizaj dega në Kaçanik për kontestet e posedimit gjatë vitit 2013.....	38
2.1.1. Diagrami 1, viti 2013	39
2.1.2. Diagrami 2, viti 2013.....	40
2.2. Lëndët e paraqitura në Gjykatën Themlore Ferizaj dega në Kaçanik për kontestet e posedimit gjatë vitit 2014.....	40
2.2.1. Diagrami 1, viti 2014	41
2.2.2. Diagrami 2, viti 2014	42
2.3. Lëndët e paraqitura në Gjykatën Themlore Ferizaj dega në Kaçanik për kontestet e posedimit gjatë vitit 2015.....	42
2.3.1. Diagrami 1, viti 2015	43
2.3.2. Diagrami 2, viti 2015	44

2.4. Lëndët e paraqitura në Gjykatën Themlore Ferizaj dega në Kaçanik për kontestet e posedimit gjatë vitit 2016.....	44
2.4.1. Diagrami 1, viti 2016	45
2.4.2. Diagrami 2, viti 2016	46
2.5. Lëndët e paraqitura në Gjykatën Themlore Ferizaj dega në Kaçanik për kontestet e posedimit gjatë vitit 2017.....	46
2.5.1. Diagrami 1, viti 2017.....	47
2.5.2. Diagrami 2, viti 2017	48
2.6. Lëndët e paraqitura në Gjykatën Themlore Ferizaj dega në Kaçanik për kontestet e posedimit gjatë vitit 2018.....	48
2.6.1. Diagrami 1, viti 2018.....	49
2.6.2. Diagrami 2, viti 2018	50
2.7. Lëndët e paraqitura në Gjykatën Themlore Ferizaj dega në Kaçanik për kontestet e posedimit gjatë vitit 2019.....	50
2.7.1. Diagrami 1, viti 2019.....	51
3. Të dhënat e pasqyruara në diagramin më poshtë do të prezantojnë të gjitha rezultatet nga posedimi për periudhën e viteve 2013-2019.....	51
3.1. Diagrami 1- Dinamika lëndëve nga posedimi shkalla e parë.....	52
3.2. Diagrami nr. 2. Mënyra e vendosjes së lëndëve në shkallën e parë për periudhën 2013-2019.....	53
3.3. Diagrami nr. 3. Mënyra e vendosjes së lëndëve në shkallën e dytë për periudhën 2013-2019.....	54
3.4. Diagrami nr. 4. Lëndët e parashtuara me objekt të kontestit për periudhën 2013-2019.....	55
Përfundimet.....	56
Rekomandimet.....	57
Bibliografia.....	58

ABSTRAKT

Posedimi është një institut juridik mjaft i rëndësishëm në të drejtën civile, me anën e të cilit krijohen dhe mbrohen të drejtat të cilat i takojnë poseduesit faktik pa marrë parasysh mënyrën e fitimit të posedimit. Meqë e drejta pronësore gëzon mbrojtje të madhe juridike, tek posedimi edhe pse jo çdoher që poseduesi është edhe pronar i sendit në të cilin e ka pushtetin faktik, i njëjti gëzon mbrojtje juridike. Posedimin, duke e nisur nga natyra e tijë mjaft shpesh e hasim si lëndë të ndryshme në gjykatat e Kosovës. Për shkak të rëndësisë së madhe që paraqet, në kuadër të kësaj teme do të trajtohen shumë aspekte të posedimit si nocioni, objekti, llojet e posedimit, fitimi, humbja, mbrojtja e posedimit etj. Duke marrë parasysh se kjo procedurë bënë pjesë në kuadër të procedurave të veçanta kontestimore, ku parashihen edhe afatet me të shkurtra për të vendosur për këto raste, gjithashtu edhe procedura e përmbarimit të vendimeve gjyqësore lidhur me kontestet nga pengimi i posedimit janë më të shkurtra dhe në raste të caktura kur përsëritet pengimi edhe pse është përmbaruar vendimi gjyqësor, me kërkesën e kreditorit mund edhe të kërkohet që të rivendoset gjendja sikur para ripengimit të posedimit.

Fjalët kyçe

Posedimi, fitimi i posedimit, bashkëposedimi, shuarja e posedimit, pengimi i posedimit, paditësi, i padituri, afatet, përmbarimi.

HYRJE

Posedimi në të drejtën sendore, por edhe në të drejtën civile në përgjithësi ka rëndësi shumë të madhe sidomos në dallimin e posedimit nga pronësia si në aspektin teorik e po ashtu edhe në aspektin praktik.

Posedimi në Republikën e Kosovës është i rregulluar me dispozita ligjore si në aspektin procedural po ashtu edhe në aspektin material. Procedura në kontestet për shkak të pengim posedimit hyn në kuadër të proceduarve të posaçme kontestimore dhe si e tillë është e rregulluar me dispozitat e nenit 478-483 të Ligjit numër 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK)¹. Me këto dispozita ligjore mundësohet rivendosja e shpejtë dhe efikase e gjendjes faktike, ku shqyrtimi i çështjes sipas padisë për shkak të pengimit të posedimit nga gjykata do të kufizohet vetëm në konstatimin dhe të provuarit e fakteve të gjendjes së fundit të posedimit dhe të pengimit të bërë. Në kuadër të kësaj procedure lidhur me të drejtën e posedimit, nuk shqyrtohet baza juridike, ndërgjegjshmëria ose pandërgjegjshmëria e posedimit dhe nuk mund të parashtrohet kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar me anë të veprimeve me të cilat është bërë pengimi i posedimit.

Në aspektin material dispozitat të cilat e rregullojnë institutin juridik të pengimit të posedimit i përmban Ligji numër 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore, i cili me nenet 103-114 ka rregulluar se çka është posedimi, posedimi pronësor, bashkëposedimi, si fitohet posedimi, si shuhet posedimi etj.²

Përmes këtij hulumtimi do të bëhet një përmbledhje e përgjithshme e institutit juridik të posedimit, do të çartësohet posedimi nga pronësia, do të dallohen llojet e posedimit si dhe mbrojta e posedimit, si dhe do të trajtohen rastet e posedimit në Gjykatën Themelore Ferizaj dega në Kaçanik për periudhën kohore 2013-2019.

¹ Ligjit për Procedurën Kontestimore 03/L-006, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: Viti Iii / Nr. 38 / 20 Shtator 2008 nenet 478-483

² Ligji numër 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore numër 03/L-154 publikuar Gazetën Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: viti iv / nr. 57 / 04.08.2009, faqe 18-19, nenet 103-114

KAPITULLI I

1. POSEDIMI

1.1. Historiku i posedimit sipas të drejtës romake

Sipas të drejtës romake për posedimin ka qenë i nevojshëm vetëm sendi (corpus) dhe vullneti që sendin ta mbaj si pronar (animus). Mirëpo sipas këtij botëkuptimi nuk ka qenë e nevojshme që poseduesi ta mbaj sendin në çdo moment, ai e mban korpusin edhe atëherë kur sendin e jep me qira ose shërbim. Ai që e ka vetëm sendin por që nuk ka dëshirë të sillet ndaj tij si pronar, nuk është posedues por vetëm mbajtës (detentor), sipas të drejtës romake qiramarrësi, huamarrësi është vetëm detentor, por nuk e ka posedimin, ai nuk e mban sendin për vehte por për pronarin. Kur ekziston posedimi e kur e ka vetëm mbajtjen sipas këtij kriteri është vetëm çështje faktike, nëse për shembull pronari i magazinës e mban qelësin e magazinës, ai është posedues edhe i vet magazinës, edhe pse përkohësisht gjendet në ndonjë vend tjetër. Mirëpo nëse e humb qelësin dhe ja vjedhin, hajni bëhet posedues vetëm i qelësit, e jo edhe i magazinës. Pra korpus tek posedimi do të thotë vetëm mundësia se ndaj sendit mund të ushtrohen ato veprime faktike të cilat mund t'i ushtroj edhe pronari. Animus është vullneti që të ushtrohen këto veprime faktike.³

Sipas të drejtës romake me parashkrim fitues, fitohej si pronësia e sendeve të luajtshme ashtu edhe pronësia e sendeve të palujatshme. Kështu në të drejtën e vjetër Romake, me parashkrim fitues mund ta fitonin pronën të gjithë qytetarët e Romës nëse ishin *sui juris* dhe kur pa ndërprerje (*sine interruptione*) kishin poseduar objektin e luajtshëm një vit, ndërsa atë të palujatshëm dy vjet⁴

Kushtet që kërkoheshin për fitimin e pronësisë me parashkrim fitues ishin: *i) res habilis* (sendit i përshtatshëm për pronë private dhe i parandaluar që të fitohet me parashkrim fitues); *ii) titulus* (justa titulus ose titulli i rregullt juridik), që përbëhej nga të gjitha mënyrat e fitimit të pronësisë të cilat nuk e kishin bërë fituesin e objektit pronar për shkak të ndonjë parregullsie; *iii) fides* (*bonae fides* ose *male fides*), në kohën e vendosjes së sendit në posedim të fituesit *iv) possessio* (posedimi fizik i sendit dhe vullneti i poseduesit që ta mbajë sendit si të vetin (*corpus et animus rem sibi habenti*) dhe *v) tempus* (qenia e sendit në posedim të

³ Gams Andrija; Bazat e së Drejtës Reale, Prishtinë, 1972, faqe 205

⁴ Dr. Puhan I.- E drejta Romake, Botim i Entit të Teksteve dhe Mjeteve Mesimore i Krahines Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë, Dhjetor 68, fq. 236

fituesit për të gjithë periudhën e përcaktuar kohore); një vit për sendet e luajtshme dhe dy vjet për sendet e paluajtshme. Afati i posedimit të sendit për efekt të parashkrimit fitues nuk plotësohej në rast se ndërpritej vazhdimi i tij përpara plotësimit të afatit të përcaktuar. Veprimet e parapara për ndërprerjen e vijimit të parashkrimit fitues kishin vetëm natyrë simbolike: thyhej një degëz e drurit, vinin në tokë, vizitonin shtëpinë e tij. Parashkrimi fitues nuk ndërpritej me paraqitjen e padisë se rei vendicatio, por me përfundimin e gjykimit në rast të pranimi të saj. Në rast të ndërprerjes së afatit të parashkrimit fitues afati i ri fillonte nga momenti i kryerjes se ndërprerjes.⁵

Parashkrimi fitues i njohur si *longi temporis praescriptio* (parashkrimi fitues i gjatë), i cili dallonte nga parashkrimi fitues për nga afatet e parashikuara dhe pasojat juridike. Kështu për parashkrimin e gjatë, kërkohej që posedimi të zgjaste 10 vjet ndërmjet banoreve të një province (*interpraesentes*) dhe 20 vjet ndërmjet banoreve të provincave të ndryshme (*inter absentes*). Dallimi ndërmjet *parashkrimit fitues* dhe *longi temporis praescriptio*, qëndron në faktin që parashkrimi fitues ishte mënyrë fitimi e pronësisë, ndërsa parashkrimi i gjatë shuante të drejtën e padisë pronësore të pronarit në rast të kundërshtimit nga poseduesi i paditur se ai e posedonte sendin për aq kohë sa kërkohej për veprimin e tij.

Në të drejtën Romake instituti i parashkrimit fitues e mori zhvillimin e tij të plotë në kohën e Justinianit, ku u shndërrua në një mënyrë të veçantë të fitimit të pronësisë.⁶

1.2. Historiku i posedimit në Republikën e Kosovës

Para kohës së Skënderbeut në viset shqiptare është aplikuar e drejta zakonore, ku nuk ka pasur ndonjë rregull të shkruar në përgjithësi, e për posedimin në veçanti. Në shekullin e XV ka filluar të aplikohet Kanuni i Lekë Dukagjinit, ky kanun nuk ka rregulluar aspektin e posedimit, por ka rregulluar disa aspekte pronësore⁷, i cili në formë të së drejtës zakonore ka gjetur zbatim një kohë të gjatë.

Pas periudhës së zbatimit të Kanunint të Lekë Dukagjinit, në territorin e Kosovës ka sunduar perandoria Osmane, në kohën e së cilës janë aplikuar dispozitat ligjore të kësaj perandorie.

⁵ Dr. Puhan I.- E drejta Romake, Botim i Entit të Teksteve dhe Mjeteve Mesimore të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë, Dhjetor 68, faqe. 237-238

⁶ Po aty, faqe. 239

⁷ Gjeçovi Shtjefën, Kanuni i Lekë Dukagjinit, Shkodër 1933, kreu i 12 faqe 33

Posedimi si institut i rregulluar juridik në Kosovë, është rregulluar me Ligjin mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore, aprovuar nga Kuvendi i RSFJ, në seancën e Dhomës Federative datë 30 janar 1980, me numër 827, në të cilin për posedimin janë paraparë dispozita të veçanta dhe është rregulluar si vijon: Posedimin e sendit e ka çdo person që ushtron drejtpërdrejt zotërimin faktik të sendit (posedimi i drejtpërdrejtë).

Posedimin e sendit e ka edhe personi që zotërimin faktik të sendit e ushtron nëpërmjet personit tjetër, të cilit në bazë të uzufruktit kontratës së shfrytëzimit të banesës, qirasë, ruajtjes, huapërdorjes ose veprimit tjetër juridik ja ka lënë sendin në posedim të drejtpërdrejtë (posedimi i tërthortë).

Posedimin e së drejtës së servitutit real e ka personi që faktikisht shfrytëzon pasurinë e paluajtshme të personit tjetër në vëllimin që i përgjigjet përmbajtjes së këtij servituti.

Disa persona mund të kenë posedimin e sendeve ose të drejtave (bashkëposedimi).

Personi në bazë të marrëdhëniesë të ngjashme ose në familje ushtron zotërimin faktik të sendit për personin tjetër, zotërimin faktik të sendit për personin tjetër, e që ka për detyrë të veprojë sipas udhëzimeve të këtij personi tjetër, nuk gëzon posedimin.

Posedimi është i ligjshëm poqëse mbështetet në bazën e plotfuqishme juridike që nevojitet për të fituar të drejtën e pronësisë dhe nëse nuk është fituar me forcë, me mashtrim ose me keqpërdorimin e besimit.

Posedimi është me mirëbesim poqëse mbajtësi nuk di ose nuk mund të dijë se sendi që e mban nuk është i tij. Mirëbesueshmëria e posedimit supozohet⁸.

Ky ligj ka qenë në fuqi nga 1 shtatori i vitit 1980 deri në qershor të vitit 2009. Pas këtij ligji, instituti i posedimit është rregulluar me Ligjin për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore me numër Ligji Nr. 03/ L-154, i cili këtë institut e ka rregulluar në nenet 103 deri 114.

1.3. Nocioni i posedimit

⁸ Ligji numër mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore, Kuvendi i RSFJ, në seancën e Dhomës Federative datë 30 janar 1980, me numër 827 nenet 70, 71, 72

Gjatë gjithë historisë ka pasur vështirësi për dhënien e një përkufizimi të saktë juridik për natyrën e posedimit. Kjo vështirësi vjen nga fakti që posedimi është një term me një përhapje të zakonshme dhe pa asnjë përcaktim të këtij nocioni juridik në të drejtë.

Posedimi si institut juridik paraqet një gjendje faktike të mbrojtur nga e drejta pozitive. Posedimi nuk konsiderohet e drejtë sendore por vetëm pushtet faktik mbi sendin, posedimi paraqitet si çështje e domosdoshme për çdo të drejtë sendore. Mbajtësi i sendit të gjetur, të vjedhur, apo të blerë nga jo pronari edhe pse sillet si pronar i sendit, ai është vetëm një posedues i thjeshtë, pra ai vetëm e ka pushtetin faktik mbi sendin dhe jo pushtetin juridik mbi të. Pushteti juridik mbi sendin i takon vetëm pronarit të vërtetë. E drejta objektive ja njeh pronësinë vetëm pronarit dhe jo çdo mbajtësi të sendit. Posedimi është pushtet faktik mbi sendin pa marrë parasysh se ky pushtet ushtrohet në bazë të së drejtës subjektive, apo ushtrohet pa bazë juridike, pavarësisht nga ajo se poseduesi beson se është i autorizuar që ta ushtroj atë pushtet faktik.⁹

Mbajtësi i sendit, i cili nuk gëzon të drejtën e pronësisë edhe pse sillet ndaj sendit si pronar dhe prej sendit të cilin e ka në posedim i mbledhë dobitë ekonomike njësoj sikurse edhe pronari i tijë, prapëseprapë ai nuk është pronar, aq më pak kur pronari i vërtetë duke u mbështetur në të drejtën e racionit, në çdo kohë mund t'ia marrë sendin poseduesit, i cili nuk është pronar. Në këtë rast bëhet fjalë për posedimin i cili nuk korrespondon me të drejtën e pronësisë, posedimi ndodhet në duart e personit, i cili nuk është pronar dhe kjo e drejtë i takon dikujt tjetër.¹⁰

Posedimi nuk është asgjë tjetër përveç se pushteti faktik ndaj sendit, ky përkufizim i posedimit është i përbashkët pothuajse në të gjitha legjislacionet. Posedimi edhe pse nuk është marrëdhënie juridiko – pronësore, ai është një kategori juridike dhe ka kuptimin e një instituti juridik. Kjo paraqet marrëdhënien faktike të pranuar nga e drejta si posedim.

Posedimi është pushtet faktik ndaj sendit, përkundër kësaj, pronësia është pushtet juridik. Zakonisht pronari ka edhe pushtetin faktik mbi sendin, qëllimi i tijë është që sendin ta shfrytëzoj dhe ta gëzoj ekonomikisht, por pronësia dhe posedimi nuk është e domosdoshme që të përputhën gjithnjë.

Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore i Republikës së Kosovës e përkrah konceptin objektiv të posedimit sipas të cilit poseduesi është secili person i cili e ushtron

⁹ Aliu Abdulla: E drejta Sendore, Prishtinë 2006, faqe 51

¹⁰ Po aty faqe 51

pushtetin faktik mbi sendin¹¹, pa marrë parasysh se me këtë rast pushtetin e mban për vete apo për personin tjetër.

Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë posedimin e parasheh:- “Posedimi është sundim efektiv i një personi mbi një send dhe mbi të drejtat reale mbi atë. Posedimi mund të ushtrohet drejtpërdrejtë ose nga një person që mban sendin.¹²

Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore i Republikës së Maqedonisë Veriore posedimin e parasheh:- “Posedim të sendit të caktuar ka çdo person, i cili drejtpërdrejtë ose nëpërmjet të të autorizuarit ushtron pushtet faktik mbi sendin (posedim i drejtpërdrejtë).

Posedim të sendit ka edhe personi i cili pushtetin faktik mbi sendin e ushtron përmes personit të tretë, të cilit në bazë të drejtës së shfrytëzimit, në bazë të kontratës së pengut, kontratës për qira, kontratës për shërbim ose ndonjë pune tjetër juridike ia ka dhënë sendin në posedim të drejtpërdrejtë (posedimi i tërthortë).¹³

Posedimin e ka ai person i cili e ka pushtetin faktik mbi sendin. Për dallim nga pronësia e cila përcakton pushtetin juridik. Posedimi humbet me vet humbjen e pushtetit faktik mbi sendin. Personi i cili e ka posedimin e gëzon mbrojtjen juridike, andaj posedimi është gjendja faktike juridikisht e mbrojtur, i cili prodhon pasoja juridike shumë të rëndësishme.

Kur themi se posedimi paraqet pushtetin faktik mbi sendet, do të thotë se duhet të egziston një akt i vullnetit pa të cilin nuk kishte për të pasur pushtet faktik mbi sendin në raport me personin tjetër. Posedimi i sendit është pushteti faktik mbi sendet dhe nuk është i domosdoshëm vullneti i poseduesit që sendin ta mban si të vetin. Për egzistimin e posedimit është e nevojshme vullneti i përgjithshëm i poseduesit që ta mbaj sendin për realizimin e ndonjë interesi.

1.4. Objekti i posedimit

Objekt i posedimit është e drejta apo pushteti faktik që një person ka mbi një send. Objekti i posedimit mund të jenë sendet e luajtshme dhe të paluajtshme, individualisht të përcaktuara,

^{11 11} Ligji numër 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore numër 03/L-154 publikuar Gazetën Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: viti iv / nr. 57 / 04.08.200 neni 103

¹² Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, mirtuar me ligjin nr.7850 të datës 29.07.1994, ndrshuar me ligjet 8536, datë 18.10.1996, 8781 datë 03.05.2001, 17/2012 datë 16.02.2012, 121/2013 datë 18.04.2013, neni 304

¹³ Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore, “Gazeta zyrtare e R.Maqedonisë” nr. 18 të 5.03.2001, neni 167

këtu bëjnë pjesë edhe frytet e shkëputura. Sendi për të qenë objekt i posedimit duhet të dalë në qarkullimin juridik, kjo bëhet me punë juridike. Sendet që janë në përdorim të përgjithshëm nuk mund të jenë objekt i posedimit, si rrugët, paraqet publike etj. Nëse mbi një send është i mundshëm fitimi i pronësisë ose e drejta e shfrytëzimit është i mundshëm edhe posedimi ndaj tij.¹⁴

Pasuritë publike nuk mund të jenë në posedim derisa për nga natyra e tyre janë të përjashtuara nga qarkullimi civilo juridik, megjithatë ndaj atyre pasurive që për nga natyra e tyre mund të jenë në qarkullim civilo juridik dhe gjenden nën regjim të veçantë administrativ – juridik është i mundshëm posedimi psh, librat në bibliotekën publike, sendet në muzeume etj.

Objekt i posedimit mund të jetë çdo send në qarkullim mbi të cilin janë të mundshme ato të drejta reale përmbajtjen e të cilave e përfshin posedimi si pushtet faktik. Pra nëse mbi një send është e mundshme pronësia ose e drejta e shfrytëzimit është i mundshëm edhe posedimi ndaj tij.¹⁵

1.5. Posedimi i të drejtave

Posedimi i të drejtave egziston atëherë kur dikush nuk e ka pushtetin e plotë faktik ndaj sendit, por vetëm të drejta të tilla që është në përmbajtje e ndonjë të drejte tjetër sendore, ai e ka posedimin e të drejtave. Tek ky lloj posedimi është e drejta, që do të thotë se objekt mund të jetë edhe një e drejtë servituti, e drejta në barrën reale, e drejta e obligacionit, që janë rezultate të ndonjë pune juridike.

Ligji me numër 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore parasheh se posedimin e së drejtës së servitutit real e ka personi që faktikisht shfrytëzon pasurinë e paluajtshme të personit tjetër në vëllimin që i përgjigjet përmbajtjes së këtij servituti¹⁶.

Posedimi i të drejtave përmban 2 elemente corpusin dhe animusin, corpusi të posedimi i të drejtave domethënë kryerja faktike e përmbajtjes esenciale të ndonjë të drejte, animusi tek posedimi i të drejtave domethënë vullneti që të ushtrohet përmbajtja e ndonjë të drejte.

¹⁴ Ademaj Qerim; Rexhepi Fejzullah: Mbrojtja Gjyqësore nga Pengim Posedimi dhe Servitutet, Prishtinë Shkurt 2018, faqe 6

¹⁵ Gams Andrija; Bazat e së Drejtës Reale, Prishtinë, 1972, faqe 214

¹⁶ Ligji numër 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore Sendore numër 03/L-154 publikuar Gazetën Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: viti iv / nr. 57 / 04.08.200, neni 252

Posedimi i të drejtave është kryerja faktike e përmbajtjes esenciale të ndonjë të drejtë të lidhur me vullnetin që përmbajtja e asaj të drejte të kryhet për vete (si e drejtë e tijë).

1.6. Elementet e posedimit

Dispozitat ligjore që janë në fuqi në Kosovë të cilat rregullojnë institutin juridik të posedimit përcakton se për të ekzistuar posedimi mjafton vetëm ushtrimi i pushtetit faktik mbi sendin.¹⁷

Mirëpo sipas shkencës, që ka zanafillën e vet në të drejtën romake, posedimi përbëhet nga dy elemente që janë:

- a) Elementi material (corpus) dhe
- b) Qëllimi për ta mbajtur sendin (animus)

Sipas nenit 169 të Kodit Civil të Shqipërisë, i cili nëpërmjet shprehjës *“duke u sjellë si pronar”*¹⁸, ka lënë të kuptohet se posedimi i sendit mund të realizohet nëpërmjet ekzistencës së dy elementeve përbërëse të tijë, që do të thotë se poseduesi e posedon sendin vetëm në rast të plotësimit të këtyre dy elementeve përbërëse të lartëcekura, elementi fizik apo mbajtjen efektive të sendit dhe elementi i brendshëm (vullnetin) e poseduesit për ta poseduar sendin (animus domini).

1.7. Llojet e posedimit

Posedimi ndahet në disa lloje:

1.7.1. Posedimi i drejtëpërdrejtë dhe posedimi tërthortë (indirekt)

- Posedimi i drejtëpërdrejtë ekziston atëherë kur personi drejtëpërdrejtë ose përmes të autorizuarit ushtron pushtetin faktik mbi sendin;
- Posedimi indirekt egziston atëherë kur personi pushtetin faktik mbi sendin e ushtron përmes një personi tjetër, i cili në bazë të frytgëzimit, kontratës mbi pengun, qirasë, shërbimit e ka sendin në posedim të drejtëpërdrejtë. Te posedimi indirekt kërkohet që sendi të përdoret në bazë të punës juridike dhe i njejtë të kthehet te poseduesi në posedim të drejtëpërdrejtë pas kalimit të kohës së paraparë me punën juridike,

¹⁷ Ligji numër 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore Sendore numër 03/L-154 publikuar Gazetën Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: viti iv / nr. 57 / 04.08.200, neni 103

¹⁸ Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.7850 të datës 29.07.1994, ndryshuar me ligjet 8536, datë 18.10.1996, 8781 datë 03.05.2001, 17/2012 datë 16.02.2012, 121/2013 datë 18.04.2013, neni 169

shembull qiramarrësi e kthen sendin te qiradhënësi¹⁹. Në këto raste person i tretë është posedues i drejtëpërdrejtë, ndërsa person i cili ka dorëzuar sendin në posedim te tjetri me punë juridike, psh kontratën e pengut është vetëm posedues indirekt. Te posedimi indirekt, kërkohet që sendi të përdoret në bazë të punës juridike dhe i njëjti të kthehet te poseduesi në posedim të drejtëpërdrejtë, pas kalimit të kohës së paraparë me punën juridike.

1.7.2. Posedimi ligjor dhe joligjor

- Posedimi ligjor është posedimi i cili mbështet në bazë juridike të vlefshme (punët juridike, vendimet etj. Posedimi i ligjshëm ka rëndësi me rastin e fitimit të të drejtave reale me parashkrim fitues. Baza duhet të jetë e vlefshme, e natyrës së tillë, që të mundësoj edhe fitimin e pronësisë.
- Posedimi jo ligjor është posedimi i cili nuk mbështet në ndonjë bazë juridike.

Emërtimi i posedimit në ligjor dhe jo ligjor varet nga egzistimi, respektivisht mos egzistimi i bazës (titullit) juridik të vlefshëm.

1.7.3. Posedimi i vërtetë dhe jo i vërtetë

- Posedimi i vërtetë është ai posedim i cili fitohet me bazë të rregullt me dorëzim të lejueshëm të sendit në pushtet faktik; Posedimi i vërtetë ose i qetë është ai posedim i cili nuk është fituar me forcë, mashtrim ose keqpërdorim e besimit. Në rastet kur posedimi bëhet me forcë, mashtrim ose keqpërdorimin e besimit ekziston posedimi jo i vërtetë. Ky lloj i posedimit bëhet i vërtetë vetëm pas kalimit të kohës, brenda të cilit personi nga i cili është marrë sendi, nuk ka ndërmarrë veprime për ta mbrojtur të drejtën e vet të posedimit.²⁰
- Posedimi jo i vërtetë është ai posedim i cili fitohet me forcë, dhunë, mashtrim.

1.7.4. Posedimi me mirëbesim dhe me keqbesim

¹⁹ Ademaj Qerim; Rexhepi Fejzullah: Mbrojtja Gjyqësore nga Pengim Posedimi dhe Servitutet, Prishtinë Shkurt 2018, faqe 7

²⁰ Aliu Abdulla: E drejta Sendore, Prishtinë 2006, faqe 64

- Posedim me mirëbesim është atëherë kur poseduesi nuk e kishte ditur ose nuk ishte i detyruar ta dinte se posedimi i tij ishte i paligjshëm. Mirëbesimi duhet të egzistonte në kohën që poseduesi hynte në posedimin e sendit. Për rrjedhojë në qoftë se poseduesi e merrte vesh më vonë se posedimi i tij ishte i paligjshëm, kjo gjë nuk merrej parasysh me përjashtim të rastit të përgjegjesisë së poseduesit për kthimin e të ardhurave dhe të vet sendit.
- Posedim me keqbesim është atëherë kur poseduesi e dinte ose ishte i detyruar ta dinte se posedimi i tij nuk bazohej në ndonjë shkak juridik. I tillë ishte personi që blinte një send nga një person duke e ditur se shitësi nuk ishte pronar i tij ose se i mungonte zotësia për të vepruar etj. Posedues me keqbesim është edhe poseduesi me mirëbesim pas marrjes së padisë për kthimin e sendit, me kusht që poseduesi ta humb kontestin në gjykatë. Mirëbesimi ndërpritet në momentin kur poseduesi merr dijeni se posedimi nuk i takon atij. Mbajtësi i sendit gjithmonë supozohet se është me mirëbesim, derisa nuk vërtetohet e kundërta. Poseduesi me keqbesim mundet të jetë ligjor me kontratë dhe i vërtetë sepse është dorëzuar sendi, por me keqëbesim, ngase e ka ditur se po e blen sendin e vjedhur.

1.7.5. Poseduesi i pavarur dhe bashkëposedimi

- Te posedimi i pavarur, poseduesi i përjashton të gjithë personat e tjerë nga pushteti faktik ndaj sendit;
- Te bashkëposedimi disa persona e ushtrojnë pushtetin faktik mbi sendin, në mënyrë që çdonjëri bashkëposedues është i kufizuar me pushtetin faktik të bashkëposeduesve tjerë²¹.

Në të drejtën sendore egziston institucioni i bashkëpronësisë, prandaj edhe gjendja faktike mund të paraqitet si bashkëposedim. Posidimi i këtillë është i mundshëm tek të gjitha të drejtat që mund të kenë më shumë titullar, për shembull, te e drejta e pronësisë, servituti, bashkëposedimi ku pushtetin faktik të poseduesit e ushtrojnë sipas pjesëve alikuote, në raste tjera bëhet fjalë për posedimin individual të një titullari.²² Përveq bashkëposedimit egziston edhe posedimi i përbashkët, kur dy a më shumë persona e ushtrojnë pushtetin faktik mbi sendin dhe nuk dihet vëllimi i ushtrimit të pushtetit faktik derisa të ndahet sendi i përbashkët

²¹ Ademaj Qerim; Rexhepi Fejzullah: Mbrotjtja Gjyqësore nga Pengim Posedimi dhe Servitutet, Prishtinë Shkurt 2018, faqe 8

²² Aliu Abdulla: E drejta Sendore, Prishtinë 2006, faqe 60

në posedim. Në të drejtën pozitive të Republikës së Kosovës parashihet: Nëse disa persona e kanë bashkëposedimin në një send, e drejta e një personi për përdorimin e sendit në raport me të tjerët dhe mbrojtja individuale e poseduesit për posedimin e tij është e kufizuar me të drejtën e personave të tjerë për përdorimin e sendit ashtu siç është paraparë përdorimi.²³

1.7.6. Posedimi pronësor

Personi i cili e posedon një send që është pronë e tij, është posedues pronësor²⁴.

2. FITIMI DHE HUMBJA E POSEDIMIT

Në të drejtën sendore, rëndësi të veçantë paraqet momenti i konstituimit të ndonjë të drejte sendore. Posedimi edhe pse nuk është e drejtë, krijimi i sajë lidhet për faktin e caktuar. Posedimi i cili paraqet pushtetin faktik mbi sendin, respektivisht mbi të drejtën, lindë me konstituimin e pushtetit faktik ndaj sendit që është objekt i posedimit²⁵.

Posedimi egziston nga momenti kur poseduesi i cili mund të jetë person fizik apo juridik, e vë sendin nën pushtetin fizik të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë. Poseduesi zakonisht është edhe pronar i sendit, por posedues mund të jetë edhe vjedhësi i sendit, gjetësi i sendit etj, i cili nga sendi që e ka në posedim nxjerr përfitime ekonomike dhe sillet sikurse të ishte sendi i tij²⁶.

2.1. Fitimi i posedimit

Fitimi i posedimit në përgjithësi kërkon konkurrimin e të dy elementeve përbërës të tij të sipërcituar të cilët janë: *corpusi* - forma me të cilën realizohet vendosja e sendit nën sundimin efektiv të fituesit dhe, *animusi* - vullneti për ta mbajtur sendin si të vetin. Fitimi i posedimit realizohet vetëm me bashkimin e elementeve të lartpërmendur, sepse posedimi fitohet me trup dhe me shpirt (vullnet). Posedimi nuk mund të fitohet as vetëm me vullnetin (*animus*) për ta poseduar sendin, pa sundimin efektiv të tij, dhe as vetëm me sundimin e trupit

²³ Ligji me numër 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore, neni 108

²⁴ Ligji me numër 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore, neni 110

²⁵ Ademaj Qerim; Rexhepi Fejzullah: Mbrojtja Gjyqësore nga Pengim Posedimi dhe Servitutet, Prishtinë Shkurt 2018, faqe 8

²⁶ Aliu Abdulla: E drejta Sendore, Prishtinë 2006, faqe 59

(*corpus*), pa pasur vullnetin për ta poseduar sendin (*adipiscimur possessionem corpore et animo, neque per se animo, aut per se corpore*)²⁷.

Futja e sendit nën sundimin efektiv të poseduesit bëhet nëpërmjet dorëzimit të sendit ose me çdo mënyrë tjetër me të cilën sendi vendoset në dispozicion të poseduesit. Ndërkohë që, vullneti për ta mbajtur sendin mund të deklarohet shprehimisht ose mund të rezultojë nga veprimet konkludente të poseduesit. Ai shprehet zakonisht me marrjen në dorëzim të sendit, por nuk mund të përjashtohet mundësia që ai të bashkohet me corpusin më vonë. Në këtë rast kemi një ndryshim të elementit animus të posedimit, dhe poseduesi, i cili ka poseduar në emër të tjetrit (*nomine alieno*), fillon të posedojë për llogari të vet, duke shkaktuar kështu humbjen e posedimit të poseduesit të mëparshëm dhe fitimin e tij për vete. Një gjë e tillë mund të ndodhë p.sh. në rastin e qiramarrësit, i cili ndryshon vullnetin për ta mbajtur sendin për qiradhënësin, dhe fillon ta mbajë sendin për vete, duke ndryshuar kështu vet titullin e posedimit (*interversio possessionis*).²⁸

Nga vet natyra e animusit kuptohet se personat që nuk kanë zotësi për të vepruar si p.sh. i mituri, personi që i është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, nuk mund të fitojnë posedimin për shkak të mungesës së vullnetit për të poseduar. Mungesa e vullnetit në fitimin e posedimit të të miturve ose personave që u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, plotësohet nga vullneti i kujdestarëve të tyre, dhe për rrjedhojë edhe këta mund të fitojnë posedimin e një sendi.²⁹

Posedimi mund të fitohet drejtpërdrejtë ose me anën e përfaqësuesit. Që të realizohet fitimi i posedimit me anën e përfaqësuesit duhet: a) që përfaqësuesi të ketë vullnetin për ta mbajtur sendin ose për të ushtruar të drejtën për llogari të të përfaqësuarit dhe b) i përfaqësuari të ketë vullnetin për të fituar posedimin e sendit, nëpërmjet përfaqësuesit të tij. Që i përfaqësuari të fitojë posedimin e sendit duhet që përfaqësuesi të marrë në dorëzim sendin.³⁰

Në të drejtën pozitive të Republikës së Kosovës fitimi i posedimit është paraparë si vijon: Posedimi në një send fitohet me krijimin e pushteti faktik mbi sendin. Marrëveshja e poseduesit të mëparshëm dhe e fituesit të posedimit është e mjaftueshme për fitimin e

²⁷ Shkurti Altin, Posedimi dhe Mbrojta e tijë, Tiranë 2015, faqe 116

²⁸ Shkurti Altin, Posedimi dhe Mbrojta e tijë, Tiranë 2015, faqe 116

²⁹ Po aty, faqe 116

³⁰ Po aty, faqe 120

posedimit, nëse fituesi është në gjendje që të ushtrojë pushtetin mbi sendin në momentin e marrëveshjes.³¹

2.1.1. Mënyrat e fitimit të posedimit

2.1.1.a. Fitimi i posedimit në mënyrë origjinere

Fitimi në mënyrë origjinere i posedimit do të thotë fitimi i posedimit pa ose kundër vullnetit të poseduesit të deritanishëm. Në këtë rast fitimi bëhet pa marrë parasysh paraardhësin, (posedimi në bazë të ligjit kur shembull kujdestari kujdeset për pasurinë e një të mituri, i cili nuk e ka arritur moshën madhore).

Posedimi në mënyrë origjinere mund të fitohet në dy mënyra: posedimi i fituar në bazë të ligjit dhe pushtimi.

2.1.1.a.1. Posedimi i fituar në mënyrë origjinere - në bazë të ligjit

Posedimi i sendit nga jo pronari mund të fitohet në bazë të ligjit. Në rastin e fitimit të posedimit të sendit në bazë të ligjit, kemi të bëjmë me një mënyrë primare (originale) të fitimit të posedimit të sendit. Posedimi i jo pronarit në këtë rast është një posedim i ligjshëm, sepse parashikohet në ligj domethënë është një posedim me shkak juridik (titull).

Fitimi i posedimi në bazë të ligjit, mbështetet vetëm në tagrin e posedimit, të palidhur me pronarin, apo ligjshmërinë e mëparshme të posedimit. Si shembuj të tillë mund të përmendim posedimin e përmbaruesit gjyqësor mbi sendet e sekuestruara, posedimi i kujdestarit të një pasurie etj.

2.1.1.a.2. Posedimi i fituar në mënyrë origjinere - Pushtimi

Një mënyrë tjetër primare e fitimit të posedimit është pushtimi si një mënyrë e fitimit të pronësisë mbi sendet e luajtshme të braktisura si dhe mbi kafshet e egra, shpendet, peshqit, frutat e egra dhe mbi sendet e tjera të luajtshme të natyres.

³¹ Ligji me numër 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore, neni 104

2.1.1.b. Fitimi i posedimit në mënyrë derivative

Fitimi në mënyrë derivative bëhet me kalimin e posedimit nga një posedues në poseduesin tjetër. Fitimi derivativ bëhet me dorëzimin e sendit dhe dorëzimi i sendit nënkupton konstituimin e posedimit p.sh trashëgimia.

Mënyrat e prejardhura ose derivative të fitimit të posedimit janë: 1) veprimi juridik, 2) akti administrativ, dhe 3. trashëgimia.

2.1.1.b.1. Fitimi i posedimit në mënyrë derivative - veprimi juridik

Kjo mënyrë e kalimit të posedimit fitohet në mënyrë të derivative nëpërmjet transferimit të së drejtës së posedimit nga pronari ose nga një person që nuk është pronar.

2.1.1.b.2. Fitimi i posedimit në mënyrë derivative - Akti administrativ

Posedimi i jo pronarit është i ligjshëm edhe në rastin kur ai fitohet në bazë të një akti administrativ. Aktet administrative që transferojnë posedimin e sendit mund të nxirren nga organet e administratës qendrore ose lokale, të cilat kanë në pronësi ose administrim pronën shtetërore.

2.1.1.b.3. Fitimi i posedimit në mënyrë derivative - Trashëgimia

Kjo është një mënyrë e fitimit të posedimit që ka të bëjë me transferimin e posedimit të pasurisë trashëgimore nga *de cujes-i* tek trashëgimtarët e tij, nëpërmjet trashëgimisë ligjore ose testamentare. Në trashëgiminë ligjore kemi një suksedim universal, që do të thotë se trashëgimtari hyn në tërësinë e të drejtave dhe detyrimeve të trashëgimlënësit, zë vendin dhe pozitën juridike të trashëgimlënësit, dhe për pasojë, ai vazhdon posedimin e pasurisë trashëgimore ashtu siç e ka pasur trashëgimlënësi i tij.

2.2. Humbja (shuarja) e posedimit

Posedimi është pushtet faktik mbi sendin. Me humbjën e pushtetit faktik mbi sendin humb edhe posedimi. Zhveshja nga pushteti faktik duhet të jetë kundër vullnetit të poseduesit. Posedimi shuhet me shkatërrimin e sendit që është objekt i posedimit, me bartjen e sendit në

persona tjerë, me shitje, me dhuratë etj.³² Humbje të posedimit kemi edhe në rastin kur sendi i kthehet poseduesit, respektivisht pronarit në bazë të padisë për rikthimin e sendit në posedim ose në bazë të padisë për mbrojtjen e pronësisë, kur këto padi përfundojnë me sukses.³³

2.2.1. Humbja e posedimit me mungesën e corpus-it dhe animus-it

Posedimi humbet me mungesën e të dy elementeve përbërës (*corpus*) dhe (*animus*) ose dhe vetëm me mungesën e njërit prej tyre. Të dy elementet përbërës të posedimit mungojnë, kur poseduesi humbet si sundimin efektiv mbi sendin, ashtu edhe vullnetin për të mbajtur sendin si të vetin p.sh. shitja e sendit, abandonimi etj.

2.2.2 Humbja e posedimit me mungesën e corpus-it

Kur pronari humbet sundimin efektiv mbi sendin, por ruan vullnetin e tij për ta poseduar sendin, vullneti i tij është pa ndonjë dobi, sepse mungon objekti. Humbja e posedimit realizohet kur pronari pengohet që të ushtrojë sundimin efektiv të tij mbi sendin, në mënyrë të qëndrueshme nga ndonjë shkak ndalues, i cili mund të vij ose nga vete sendi ose nga një ngjarje e natyrës si p.sh. humbja e sendit, largimi i tufës së bletëve, shkëputja e një cope toke të ngjitur në bregun e lumit dhe transportimi i saj.³⁴

2.2.3 Humbja e posedimit me anë të përfaqësuesit

Posedimi i sendit i realizuar nëpërmjet përfaqësuesit, gjithashtu mund të humbet kur mungon vullneti i të përfaqësuarit, si dhe kur vullneti për ta mbajtur sendin kalon nga i përfaqësuari tek përfaqësuesi, p.sh. qiramarrësi, uzufruktari, depozitari etj. ndryshon vullnetin për ta mbajtur sendin për vete (*interversio possessionis*).³⁵

Posedimi i realizuar nëpërmjet përfaqësuesit mund të humbas kur nëpërmjet humbjes së sundimit efektiv të sendit të poseduar, p.sh. uzufruktari, depozitari etj vishet nga posedimi i sendit.

³² Sulejmani Shukri, E Drejta Civile, Akademia e Drejtësisë, Prishtinë, Tetor 2017, faqe 25

³³ Aliu Abdulla: E drejta Sendore, Prishtinë 2006, faqe 71

³⁴ Shkurti Altin, Posedimi dhe Mbrojta e tijë, Tiranë 2015, faqe 121

³⁵ Po aty, faqe 121

KAPITULLI II

1. Mbrojtja e posedimit

Posedimi gëzon mbrojtjen juridike, posedimi është një gjendje faktike, kurse parimi i përgjithshëm juridik, i cili ka rëndësi jo vetëm në të drejtën civile por edhe në degë të tjera të drejtësisë është një gjendje egzistuese faktike që duhet të mbrohet. Askush nuk mund të çënoj pushtetin faktik në mënyrë arbitrare, por vetëm me ndihmën e organeve kompetente. Poseduesi i sendit ka të drejtë në mbrojtje nga shqetësimet (pengimet) ose nga marrja e sendit nga posedimi, ku në këtë rast zhvishte nga posedimi i sendit.

Ashtu siç është theksuar edhe në hyrje të këtij punimi, posedimi gëzon mbrojtje juridike. Posedimi është i rregulluar me dispozita ligjore si në aspektin procedural po ashtu edhe në aspektin material. Në Republikën e Kosovës, në aspektin procedural posedimi mbrohet me dispozitat e neneve 478-483 të Ligjit numër 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK), kurse në aspektin material posedimi mbrohet me dispozitat e neneve 103-114 të Ligjit numër 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore. Askush nuk mund ta çënoj pushtetin faktik në mënyrë arbitrare, por vetëm me ndihmën e organeve kompetente. Poseduesi i sendit ka të drejtë në mbrojtje nga shqetësimet (pengimet) ose nga marrja e sendit nga posedimi, ku në këtë rast poseduesi zhvishet nga posedimi i sendit.

1.2. Kompetenca

Në kontestet për shkak të pengimit të posedimit në pikëpamje territoriale ekskluzivisht kompetente është gjykata në territorin e së cilës ndodhet sendi i palujtshëm në të cilin egziston posedimi³⁶

Në sendet e luajtshme, kur kemi pengim kompetenca është sipas zgjidhjes së paditësit. Në këtë rast paditësi mund të paraqes padinë ose në gjykatën e kompetencës territoriale të

³⁶ Ligji për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006, neni 41.1

përgjithshme (gjykata në territorin ku i padituri ka vendbanimin ose vendqëndrimin neni 37 dhe 38 i LPK) ose në gjykatën në territorin e së cilës është bërë pengimi³⁷.

1.3. Llojet e padive për mbrojtjen e posedimit

Për mbrojtjen e posedimit egzistojnë dy padi:

- a) Padia për pengim të posedimit dhe
- b) Padia për kthimin e posedimit

Me Ligjin për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore të Republikës së Kosovës parashihet se secili mbajtës i sendit dhe i të drejtës gëzon mbrojtje juridike, qoftë nga privimi, nga posedimi apo edhe nga posedimi në posedim.

1.3.1. Padia për pengim posedimin

Mjeti kryesor me anën e të cilit poseduesi mbron posedimin e tij është padia për pengimin e posedimit. Ligjvënësi në Republikën e Kosovës ka parashikuar në nenet 111-113 të Ligjit për Pronësinë dhe të drejtat Sendore mbrojtjen e posedimit. Në nenin 113 thuhet se: *Nëse poseduesi privohet nga posedimi në mënyrë të kundërligjshme, poseduesi mund të kërkojë rivendosjen e posedimit prej personit ndërhyrës, i cili në raport me poseduesin është në posedim me të meta; Nëse poseduesi pengohet në posedim në mënyrë të kundërligjshme, atëherë poseduesi mund të kërkojë nga penguesi mënjanimin e pengesave. Nëse priten pengime në të ardhmen, poseduesi mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore; Kërkesa kundër ndërhyrjes në posedim është e përjashtuar në qoftë se poseduesi e ka posedimin me të meta në raport me penguesin ose të drejtën e paraardhësit të penguesit.*

1.3.1.1. Pengimi i posedimit

Perkufizim i pengimit të posedimit hedh dritë mbi elementet që përbejnë pengimin e posedimit. Kështu, pengimi i posedimit përbëhet nga dy elemente që janë elementi objektiv,

³⁷ Po aty, neni 52

që konsiston në pengimin që i kryhet posedimit të poseduesit dhe elementi subjektiv, i cili konsiston në faktin që pengimi i posedimit duhet të jetë kryer në kundërshtim me vullnetin e poseduesit (*animus spoliandi*). Elementi subjektiv i pengimit të posedimit, manifestohet në dashje direkte të cenesit për të realizuar zhveshjen e plotë të sendit, kundër vullnetit të poseduesit, pavarësisht konceptimit nga ana e tij e fakti që sendi ndodhet në posedimin e poseduesit. Ndërsa elementi subjektiv i pengimit të posedimit, nuk paraqet ndonjë rëndësi, për sa kohë që vendimmarrja gjyqësore nuk përjashton nga përgjegjësia ligjore edhe cenesin që e kryen pengimin e posedimit pa dashje direkte.³⁸

Pengimet që i bëhen posedimit mund të jenë pengime fakti ose pengime të drejtave.

Pengime fakti kemi kur veprimet e personave të tretë prekin materialisht posedimin p.sh. kur një person kalon ose bën ndërtime në tokën e tjetrit, mbledh ose vjel frutat natyrore ose civile të sendit etj.

Pengime të drejte kemi kur veprimet e personave të tretë synojnë të pengojnë poseduesin në ushtrimin e tagres së tij të posedimit p.sh. ndalimi i poseduesit për të ndërtuar duke pretenduar se ka një të drejtë servituti që të mos ndërtohet tej një lartësie të caktuar, ndalimi i pagimit të qirave duke e konsideruar veten pronar të sendit të marrë me qira etj.

Padia për pengimin e posedimit mund të ushtrohet nga pronari i sendit ose nga poseduesi jo pronar. Në rastin kur sendi që cenohet është në bashkëpronësi të disa personave padia për pushimin e pengimit të posedimit mund të ngrihet nga njëri prej bashkëpronarëve, edhe pa qenë sendi në posedimin ekskluziv të tij³⁹. Padia për pushimin e pengimit të posedimit mund të ngrihet edhe midis bashkëpronarëve. Ajo mund të pranohet vetëm në rastin kur bashkëpronari provon se është posedues ekskluziv i sendit të përbashkët dhe cënohet në posedimin e tij nga bashkëpronarët e tjerë.

Padia për pushimin e pengimit të posedimit mund të ngrihet nga çdo posedues, i ligjshëm ose i paligjshëm, me mirëbesim ose me keqbesim.

³⁸ Shkurti Altin, Posedimi dhe Mbrojta e tijë, Tiranë 2015, faqe 124

³⁹ Po aty, faqe 125

1.3.1.2. Kundër kujt mund të ngrihet padia për pushimin e pengimit të posedimit (legjitimimi pasiv)

Poseduesi i sendit ka të drejtë që të ngrejë padinë për pushimin e pengimit të posedimit kundrejt personit që ka penguar materialisht posedimin ose kundër trashëgimtarëve të tij. Pra, padia e pushimit të pengimit të posedimit ngrihet kundër personave të cilët cenojnë materialisht posedimin ose mbajtësin e sendit, nëpërmjet veprimeve që shkaktojnë shqetësimet ose që pengojnë ushtrimin e tagres së gëzimit të sendit që është në posedimin.⁴⁰

1.3.1.3. Objekti i padisë së pushimit të pengimit të posedimit

Objekti i padisë së pushimit të pengimit të posedimit është: njohja e posedimit të paditësit, detyrimi i të paditurit që të pushoj pengimin e posedimit dhe të mos e përsërisë më në të ardhmen. Objektit të kërimit të padisë për pushimin e pengimit të posedimit mund t'i bashkohen edhe kërkesa të tjera si p.sh. kërkesa për kthimin në gjendjen e mëparshme etj.

Nga objekti i posedimit përjashtohen pronat e paluajtshme publike të patjetërsueshme. Pronësia e këtyre pasurive i përket shtetit dhe për rrjedhojë mbi këto pasuri nuk mund të konstituohet një posedim i ligjshëm. Pronësia mbi këto pasuri nuk mund të fitohet nga personat privat as nëpërmjet veprimit të dispozitave të parashkrimit fitues, por pavarësisht këtij fakti, këto pasuri mund tu ipen në shfrytëzim personave privat në bazë të kontratave administrative, apo në rast të këmbimit të pronave të paluajtshme në interes shtetëror.

Padia posedimore e pushimit të pengimit të posedimit mund të ushtrohet për mbrojtjen e të drejtave reale që kanë të bëjnë me pasuritë e paluajtshme, si p.sh. uzufruktari, si dhe nga të gjithë personat që posedojnë këto të drejta reale. Padia posedimore e pushimit të pengimit të posedimit nuk mund të ushtrohet për mbrojtjen e një të drejte reale garancie, si p.sh. nga kreditori hipotekor, sepse hipoteka, siq është argumentuar me sipër, nuk përbën objekt posedimi⁴¹.

1.3.2. Padia për rivendosjen në posedim (rikthimin në posedim)

⁴⁰ Shkurti Altin, Posedimi dhe Mbrojtja e tij, Tiranë 2015, faqe 126

⁴¹ Po aty, faqe 126

Padia për rivendosjen në posedim parashikohet në nenin 113 të Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore 0/L-154 neni 113 paragrafi 1. Në këtë nen thuhet se: 'Nëse poseduesi privohet nga posedimi në mënyrë të kundërligjshme, poseduesi mund të kërkojë rivendosjen e posedimit prej personit ndërhyrës, i cili në raport me poseduesin është në posedim me të meta.

Padia për rivendosjen në posedim i shërben poseduesit, kundër zhveshjes që i bëhet posedimit të tijë, të kryer nga persona të tretë në mënyrë të paligjshme.

1.3.2.1. Zhveshja e paligjshme e posedimit

Me zhveshje duhet kuptuar çdo veprim që shkakton heqjen e plotë ose të pjesshme të sendit nga posedimi i poseduesit. Zhveshja e poseduesit mund të kryhet edhe me dhunë ose në fshehtësi.

Zhveshja me dhunë konsiston në kryerjen e veprimeve arbitrare të cilat qëllimisht (*animus spoliandi*) i heqin poseduesit posedimin e sendit kundër dëshirës së tijë ose e ndalojnë ushtrimin e lirë të tijë. Dhuna mund të jetë fizike ose psikike. Dhuna psikike kryhet nëpërmjet frikësimit ose kanosjes së poseduesit. Përgjithësisht në doktrinë por edhe në jurisprudencë, gëzon prioritet maksimal parimi sipas të cilit: përbën një zhveshje të dhunshme nga posedimi, çdo veprim kundër vullnetit të shprehur apo të prezumuar të poseduesit apo të nëdorësit e që sjellë si pasojë heqjen e posedimit të sendit, duke pasur si domosdoshmëri praninë e akteve të vërteta të dhunës. Doktrina prevalente i jep kriterit të dhunës një interpretim të gjërë duke konsideruar kështu zhveshje me dhunë çdo marrje të posedimit të sendit pa pëlqimin e poseduesit. I dhunshëm konsiderohet në këtë kuader, edhe refuzimi që i bëhet poseduesit nga shfrytëzuesi i sendit në qastin kur me mbarimin e kontratës përkatëse të qirasë nuk pranon që t'ia kthejë atij. Për rrjedhojë zhveshja me dhunë merr në konsideratë edhe vullnetin e personit që zhvishet nga posedimi i cili mund të jetë i shprehur ose i prezumuar.⁴²

Fshehtësia. Zhveshja e poseduesit me fshehtësi realizohet në mënyrë të fshehtë, pa qenë poseduesi në gjendje të kuptojë në mënyrë të plotë dhe të menjëhershme se sendi ka dalë nga

⁴² Shkurti Altin, Posedimi dhe Mbrojta e tijë, Tiranë 2015, faqe 129

pushteti faktik i tij. Elementi i padijenisë në këtë rast i kundëdrejtohet poseduesit, pa pasur ndonjë rëndësi fakti që zhveshja është perceptuar ose jo në persona të tretë.

Zhveshja e poseduesit duhet të jetë kurdoherë e *'paligjshme'*. Kështu nuk është e paligjshme zhveshja e posedimit e kryer në kushtet e vetëmbrojtjes ose në kushtet e ekzekutimit të një sekuestrimi nga përmbartuesi privat apo gjyqësor. Kjo zhveshje është një zhveshje e ligjshme, sepse subjektet e veprimit juridik kryejnë veprime që janë lejuar nga ligji, d.m.th. veprojnë në bazë të ligjit. Në këtë rast nuk kemi vend për zbatimin e padisë posedimore të rivendosjes në posedim, sepse nuk plotësohet kushti i zhveshjes së poseduesit në mënyrë të paligjshme.⁴³

1.3.2. 2. Kush mund të ngrejë padinë për rivendosjen në posedimit (*legjitimimi aktiv*)

Padia për rivendosjen në posedim mund të ngrihet nga pronari i sendit ose nga poseduesi jo pronar. Si rregull ajo mund të ngrihet nga çdo posedues i ligjshëm ose i paligjshëm, me mirëbesim ose keqbesim. Si përjashtim nga rregulli, padia për rivendosjen në posedim nuk mund të ngrihet nga poseduesi që e ka fituar posedimin e tij mbi sendin nëpërmjet dhunës ose fshehtësisë, pasi posedimi i tij është fituar në mënyrë të kundërligjshme.

Kur sendi është në bashkëpronësi padia për rivendosjen në posedim mund të ngrihet nga secili bashkëpronar. Megjithatë ajo mund të pranohet vetëm kur bashkëpronari provon se është posedues ekskluziv i sendit të përbashkët dhe cenohet në posedimin e tij nga bashkëpronarët e tjerë. Padia posedimore për rivendosjen në posedim mund të përdoret nga bashkëpronarët, e tjerë për të konservuar posedimin, në rastin kur njeri prej bashkëpronareve fillon të posedojë sendin ekskluzivisht duke cënuar kështu posedimin dhe gëzimin e sendit nga bashkëpronarët e tjerë.⁴⁴

1.3.2.3. Kundër kujt mund të ngrihet padia për rivendosjen e posedimit (*legjitimimi pasiv*)

Padia për rivendosjen në posedim mund të ngrihet kundrejt atij që ka zhveshur poseduesin nga posedimi i tij ose kundër trashëgimtarëve të tij.

1.3.2. 4. Objekti i padisë për rivendosjen në posedim

⁴³ Shkurti Altin, Posedimi dhe Mbrojtja e tij, Tiranë 2015, faqe 129

⁴⁴ Po aty, faqe 130

Objekt i padisë për rivendosjen në posedim është: njohja e posedimit të sendit nga poseduesi dhe rivendosja e sendit në posedimin efektiv të poseduesit. Me padinë për rivendosjen në posedim mund të bashkohen edhe kërtime të tjera si p.sh. kthimi në gjendjen e mëparshme.

1.4. Afatet për paraqitjen e padive

Poseduesi i sendit ka të drejtë të kërkojë mbrojtje gjyqësore nga pengimi i posedimit që në afat prej 30 ditësh (afati subjektiv) nga marrja e dijenisë për pengimin dhe penguesin, e më së voni brenda afatit 1 vjeçar (afati objektiv) nga dita e pengimit⁴⁵. Pas kalimit të afatit objektiv padia nuk mund të ngritet edhe pse ndoshta ende nuk ka kaluar afati subjektiv. Afatet e përmendura janë afate prekluzive të së drejtës materiale, ku për respektimin e tyre gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare. Në qoftëse padia paraqitet pas kalimit të tyre, kërkesëpasia refuzohet. Në rast se pengimi i posedimit përsëritet, afati për padi fillon nga marrja e dijenisë për çdo pengim të ri.

Padia me të cilën vihet në veprim kjo procedurë është e natyrës kondemnatore dhe me të mund të kërkojë rivendosja e gjendjes para se të bëhet pengimi, por edhe ndalimi i pengimit për në të ardhmën.⁴⁶

1.5. Barra e provës në paditë posedimore dhe prezumimet ligjore

Sipas parimeve të përgjithshme të së drejtës civile barra e proves (*onus probandi*) i përket paditesit, ndërsa palës së paditur i njihet e drejta e prapësimit dhe e provimit të së kundërtës. Paditesi detyrohet të provojë se është posedues i sendit. Për të lehtësuar vërtetimin e faktit që paditësi është posedues i sendit, ligjvënasi ka parashikuar disa prezumime ligjore që i referohen të dy elementeve të posedimit; elementit trupor (*corpus-it*) dhe elementit vullnetar (*animus-it*)⁴⁷.

1.6. Prezumimet që i referohen corpusit

i) Poseduesi i tanishëm, që ka poseduar sendin në një kohë të mëparshme, prezumohet se ka poseduar edhe në kohën e ndërmjetme. Mjafton që poseduesi të provojë se e ka poseduar

⁴⁵ Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore 0/L-154 neni 113 paragrafi 1 dhe 2

⁴⁶ Brestovci Faik, E Drejta Procedurale Civile II, Prishtinë, 2006 fq 127-128

⁴⁷ Shkurti Altin, Posedimi dhe Mbrojtja e tijë, Tiranë 2015, faqe 131

sendin në një kohë të mëparshme dhe e posedon dhe tani për të prezumuar posedimin e tij edhe për kohën ndërmjet posedimeve⁴⁸.

ii) Posedimi i tanishëm nuk prezumon posedimin e mëparshëm, megjithatë poseduesi i tanishëm nuk është i detyruar të provojë se ka qenë posedues i mëparshëm kur posedimi i tij është me shkak juridik, d.m.th mbështetet mbi një titull⁴⁹.

1.7. Prezumimi që i referohet animusit

Se çdo person posedon për vete edhe si pronar, derisa nuk provohet se ka filluar të posedojë në emër të ndonjë personi tjetër. Ky prezumim nuk është i parashikuar nga ligji por del nga vetë përmbajtja e posedimit. Prezumimet ligjore të lartpërmendura janë prezumime relative dhe vlejnë deri në provimin e së kundërtës, çka do të thotë se me provimin e faktit të kundërt, p.sh. që poseduesi nuk ka poseduar në kohën e ndërmjetme, për shkak të zhveshjes së posedimit të sendit, prezumimi ligjor rrëzohet.⁵⁰

1.8. Shpërblimi i dëmit në gjykimet posedimore

Gjatë kohës që sendi ka dalë nga posedimi i poseduesit dhe mbi të ushtrohet pushteti i zhveshësit të posedimit, poseduesi i ligjshëm nuk përfiton frutat civile ose natyrore të maturuara gjatë kohës që ai është në posedimin e zhveshësit. Mund të ndodhë gjithashtu, që sendi të dëmtohet ose të shkatërrohet gjatë kohës që është në posedimin e cënuesit të posedimit ose të fitohet me mirëbesim nga një i tretë dhe për rrjedhojë sendi nuk mund të rivendoset më në posedimin e poseduesit. Po kështu mund të ndodhë që poseduesi të mos përfitojë nivelin e pritshëm nga gëzimi i sendit ose dobitë e tij, për shkak të pengimit të drejtës së tij të gëzimit të sendit.

Në këto situata vetëkuptohet se pengimi apo zhveshja që i shkaktohet posedimit të sendit nuk rikupërohet plotësisht me anë të padive posedimore. Me të drejtë në këtë rast poseduesi mund të rikupërohet për dëmin e pësuar vetëm nëpërmjet shpërblimit të dëmit të shkaktuar. Duke marrë shkas nga karakteri i veçantë, i gjykimit posedimor me të drejtë mund të lindin

⁴⁸ Po aty, faqe 131

⁴⁹ Shkurti Altin, Posedimi dhe Mbrojta e tij, Tiranë 2015, faqe 131

⁵⁰ Po aty, faqe 131

diskutime të karakterit procedural, që kanë të bëjnë me faktin nëse kërkimi për shpërblimin e dëmit në këtë rast duhet parashtruar si një kërkim i veçantë i padisë posedimore apo përfshihet nga vete ato pa qenë e nevojshme që të kërkohet shprehimisht⁵¹

Te paditë posedimore, dëmi i shkaktuar nuk mund të shpërblehet nga gjykata në rast se nuk i kërkohet asaj shprehimisht si një kërkim i veçantë. Por gjykimi posedimor përbën një gjykim *sui generis*, i cili për shkak të natyrës së tij nuk mund të lejoj që kërkimi për shpërblimin e dëmit ti bashkengjitet si kërkesë e veçantë padisë posedimore. Për rrjedhojë kërkimi i shpërblimit të dëmit nuk mund të bëhet veqse me një gjykim të veçantë. Për rrjedhojë edhe në rastin kur padia posedimore përmban si kërkesë të veçantë shpërblimin e dëmit, kjo kërkesë duhet të veçohet dhe të gjykohet në një gjykim të veçantë. Në këtë gjykim të veçantë poseduesi i pengua ose i zhveshur mund të dëmshpërblehet vetëm për vlerën e dëmit që i është shkaktuar atij si posedues nga mos përfitimi i frutave civile ose natyrore të sendit, gjatë kohës së zhveshjes nga posedimi i sendit ose për shkak të mos përfitimit të plotë nga gëzimi ose dobisë së sendit. Ai nuk mund të kërkojë që të dëmshpërblehet për vlerën e plotë të sendit, sepse ky shpërblim nuk i përket atij, por pronarit të sendit.⁵²

1.9. Dallimi i padisë posedimore nga padia e rivendikimit dhe padia negatore

Padia posedimore për pushimin e pengimit të posedimit ngjan me padinë negatore, kurse padia posedimore për rivendosjen në posedim ngjan me padinë e rivendikimit. Megjithatë midis këtyre padive ka edhe dallime:

a) Padia posedimore për pushimin e pengimit posedimor dhe padia posedimore për rivendosjen në posedim mbështeten në të drejtën e posedimit, dhe për rrjedhojë ato mund të ngrihen nga çdo posedues, pronar ose jo pronar, kurse padia negatore dhe padia e rivendikimit mbështeten në të drejtën e pronësisë, dhe për rrjedhojë ato mund të ngrihen vetëm nga pronari.

b) Padia për rivendosjen në posedim mund të ngrihet vetëm kundër atij që ka zhveshur pronarin nga posedimi i sendit kundër trashëgimtarëve të tij ose kundër personave të tretë që u ka kaluar sendi, të cilët kanë pasur dijeni për zhveshjen e ndodhur, kurse padia për

⁵¹ Po aty faqe 132

⁵² Shkurti Altin, Posedimi dhe Mbrojta e tijë, Tiranë 2015, faqe 132

rivendikimin e sendit mund të ngrihet jo vetëm kundër atij që i ka hequr sendin pronarit, por edhe kundrejt cilit do person që e mban sendin.

c) Paditë posedimore parashkruhen me kalimin e afatve ligjre nga dita e pengimit, kurse padia e rivendikimit dhe padia negatore është e pa parashkrueshme⁵³.

1.10. Natyra e kontesteve

Me rastin e caktimit të afateve dhe konvokimit të seancave gjykata gjithmonë duhet t'i kushtojë kujdes nevojës së zgjidhjes së ngutshme të kontesteve për shkak të pengimit të posedimit, por duke marrë parasysh natyrën e secilit rast konkret.⁵⁴

1.11. Objekti i kontesteve

Në rastet e padive për shkak të pengim posedimit e gjithë veprimtaria procedurale pranë gjykatës duhet drejtuar nga konstatimi i gjendjes së fundit të posedimit dhe nga konstatimi i pengimit. Është përjashtuar shqyrtimi i të drejtës mbi posedimin, bazës juridike të posedimit, ndërgjegjshmërisë së poseduesit, kërkesës për dëmshpërblim për dëmin e shkaktuar me anë të veprimeve me të cilat është bërë pengimi i posedimit etj. Pengimi i posedimit është çdo veprim me vetëdije të personit të tretë me të cilin veprim poseduesi i sendit është i shqetësuar në shfrytëzimin e sendit ashtu siç e ka shfrytëzuar më parë. Në këtë procedurë gjykta shqyrton dhe vendos lidhur me padinë vetëm për mbrojtjen faktike të posedimit⁵⁵.

Në padinë për pengim posedimin duhet në mënyrë precize të përcaktohet – përshkruhet pengimi i posedimit, mënyra (akti dhe koha e pengimit) si dhe çka i urdhërohet të paditurit. Padi e cila nuk përmban të tëra këto nuk është e plotë dhe si e tillë nuk është e përshtatshme për shqyrtim në kuptim të nenit 102 të LPK –së. Andaj gjykata padinë e tillë duhet t'ia kthej paditësit që në afat të caktuar t'i eliminoj mangësitë, ku në rast mosveprimi nga ana e paditësit, padia do t'i hedhet poshtë.⁵⁶

Me rastin e vendosjes për padi për shkak të pengimit të posedimit, gjykata është e detyruar të vërtetoj se me veprimin e pengimit, poseduesi është privuar nga posedimi në mënyrë të

⁵³ Po aty, faqe 133

⁵⁴ Ligji për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006, neni 479

⁵⁵ Brestovci Faik, E Drejta Procedurale Civile II, Prishtinë, 2006 fq 128-129

⁵⁶ Ademaj Qerim; Rexhepi Fejzullah: Mbrojtja Gjyqësore nga Pengim Posedimi dhe Servitutet, Prishtinë Shkurt 2018, faqe 8

kundërligjshme, apo në mënyrë të kundërligjshme vetëm është penguar në posedimin e një sendi apo të drejte.

Poseduesit i njihet edhe e drejta në vetëgjyqësi për mbrojtjen e të drejtës së posedimit në bazë të nenit 112 të Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore 0/L-154 ndaj personit i cili e shqetëson në posedim ose e ka marrë posedimin por kjo realizohet me kusht që rreziku duhet me qenë i drejtëpërdrejtë, që vetëmbrojtja të është e nevojshme dhe mënyra e kryerjes së sajë t'i përgjigjet rrethanave në të cilat ekziston rreziku. Kjo formë e mbrojtjes së posedimit nënkupton realizimin dhe sigurimin e mbrojtjes subjektive nga vetë titullari i sajë, i cili për këtë qëllim e përdor forcën fizike. Në këtë kontest mbrojtja juridiko civile mundëson një mbrojtje më të plotë të drejtës së pronësisë, e cila edhe është në përputhje me përmbajtjen e asaj të drejte. Kështu poseduesi i sendit të drejtën e vet e mbron me padi juridiko civile kur i merret sendi apo pengohet në posedimin e tij.⁵⁷

1.12. Vendimet

Në procedurën për shkak të pengimit, lidhur me kërkesëpadinë e paditësit gjykata vendos me aktvendim. Në këtë drejtim mesiguri ka ndikuar karakteri provizor i mbrojtës juridike, e cila jepet në gjykimet e llojit të tillë. Nëse gjykata konstaton se kërkesëpadia e paditësit është e pa themeltë, gjykata me aktvendim (kondemnator) detyruet e detyron të paditurin (varësisht prej kërkesës) që ta kthej sendin e marrë, që ta rivendos gjendjen e mërpashme, apo që të përmbahet nga veprimet e drejtuara kah shqetësimi, pengimi apo marrja e sendit⁵⁸.

Afatin për përmbushjen e detyrimeve që u janë caktuar palëve me rastin e vendosjes lidhur me kërkesëpadinë në rastet e pengim posedimit, gjykata e cakton varësisht nga rrethanat e çdo rasti konkret⁵⁹. Mirëpo zakonisht në praktikën gjyqësore të gjykatave të Republikës së Kosovës si afat për përmbushjen e detyrimeve në mënyrë vullnetare nga ana e palëve jepet afati 7 ditor duke llogaritur nga dita e marrjes së aktvendimit, që sipas mendimit tonë është afat i arsyeshëm dhe jo i shkurt, për shkak të natyrës urgjente që ka procedura lidhur me pengim posedimin.

1.13. Masat siguruese

⁵⁷ Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore 0/L-154 neni 112

⁵⁸ Brestovci Faik, E Drejta Procedurale Civile II, Prishtinë, 2006 fq 129

⁵⁹ Ligji për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006, neni 481 par 1

Me dispozitat ligjore të nenit 478-483 të Ligji për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006 (LPK – së), të cilat e rregullojnë procedurën në kontestet për shkak të pengim posedimit, nuk është paraparë shprehimisht mundësia e caktimit të masës së përkohshme siguruese, mirëpo dispozita e nenit 478 të LPK ka përcaktuar shprehimisht se *“Poqëse në këtë kapitull nuk ekzistojnë dispozita të posaçme, në kontestet për shkak të pengim posedimit zbatohen dispozitat tjera të këtij ligji”*.

1.14. Mjetet juridike

Tek rastet e pengim posedimit, aktvendimi me të cilin pranohet apo refuzohet kërkesëpadia mund të goditet me ankesë të posaçme. Ankesa ka efekt suspensiv, por gjykata për shkaqe të rëndësishme mund të vendos që ankimi të mos e pengoj ekzekutimin e vendimit me të cilin është pranuar si e themelt kërkesëpadia. Afati për paraqitjen e ankesës është 7 ditor⁶⁰.

Kundër aktvendimeve të dhëna në kontestet për shkak të pengimit të posedimit revizioni nuk është i lejuar⁶¹, ndërsa përsëritja e procedurës së përfunduar me vendim të formës së prerë lejohet vetëm nga shkaqet e përcaktuara me nenin 232 pika a) dhe b) të LPK-së dhe atë brenda afatit prej 30 ditësh nga dita në të cilën është bërë i formës së prerë aktvendimi përfundimtar⁶².

1.15. Ekzekutimi i vendimeve

Ekzekutimi i detyrueshëm në bazë të aktvendimit të dhënë në kontestin për shkak të pengim posedimit mund të kërkohe brenda afatit 30 ditor nga dita e kalimit të afatit paritiv. Afati paritiv për përmbushje vullnetare të detyrimit të caktuar me vendim meritohet varësisht nga rrethanat e rastit konkret. Kjo do të thotë se ai mund të jetë më i gjatë apo më i shkurtur se afati për ankim⁶³.

I përshtatshëm për ekzekutim të detyrueshëm është vendimi kondemnator (detyrues) me të cilin të paditurit i është urdhëruar që të kryej një veprim të caktuar. Veprimi me të cilin pranohet kërkesëpadia e ka rëndësinë e dokumentit ekzekutiv dhe i njejti sipas propozimit të

⁶⁰ Ligji për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006, neni 481 par 2

⁶¹ Ligji për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006, neni 481 par 4

⁶² Ligji për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006, neni 483

⁶³ Ligji për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006, neni 482

paditësit mund të përmbarohet nga organi përmbarues sipas rregullave të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, në rast se i padituri brenda afatit parativ në mënyrë vullnetare nuk e përmbush detyrimin e përcaktuar me anë të vendimit të dhënë⁶⁴.

Për të vendosur për propozimin përmbarimor, në qoftëse debitori në bazë të dokumentit përmbarues ka për detyrë të kryej veprimin e caktuar apo t'i duroj veprimet e caktuara, ose të përmbahet nga veprimi i caktuar, përmbaruesi privat ka kompetencë për të vendosur mbi propozimin përmbarimor dhe të zbatoj përmbarimin⁶⁵. Në qoftëse në bazë të dokumentit përmbarimor, të nxjerr sipas padisë për shkak të pengimit të posedimit, është kryer përmbarimi, apo në qoftë se debitori e ka përmbushur vullnetarisht detyrimin e vet, kurse pas kësaj përsëri e bënë pengimin e posedimit, i cili në esencë nuk dallohet nga pengimi i mëparshëm, organi përmbarues me propozimin e kërkuarit të përmbarimit, në bazë të dokumentit përmbarues të njëjtë, do të nxjerr aktvendim të ri për përmbarim apo urdhërin përmbarues, me qëllim të rivendosjes së gjendjes së mëparshme nëse kjo është e nevojshme. Kërkuari i përmbarimit mund ta parashtroj kërkesën brenda afatit prej 30 ditësh, nga dita kur ka marrë dijeni për ri –pengimin e posedimit, por jo më vonë se 1 vit nga pengimi i përsëritur⁶⁶.

1.16. Krahassimi i mbrojtjes së posedimit në mes të Republikës së Kosovës me Republikën e Shqipërisë dhe Republikën e Maqedonisë Veriore

Në Republikën e Kosovës instituti i posedimit është i rregulluar me Ligjin për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore numër 03/L-154 publikuar Gazetën Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: viti iv / nr. 57 / 04 gusht 2009 Shpallur me dekretin Nr. DL-016-2009, datë 15.07.2009 nga nenet 103 deri 114.

⁶⁴ Ligji për Procedurën Përmbarimore numër 04/L-139 neni 21 dhe 22

⁶⁵ Ligji për Procedurën Përmbarimore numër 04/L-139 neni 291

⁶⁶ Ligji për Procedurën Përmbarimore numër 04/L-139 neni 297

Në Republikën e Maqedonisë Veriore instituti i posedimit është i rregulluar me Ligjin për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore “Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 18 të datës 05.03.2001 në nenet 167 deri 191.

Në Republikën e Shqipërisë instituti i posedimit është i rregulluar me Kodin Civil i Republikës së Shqipërisë, mirtuar me ligjin nr.7850 të 36ates 29.07.1994, ndryshuar me ligjet 8536, datë 18.10.1996, 8781 datë 03.05.2001, 17/2012 datë 16.02.2012, 121/2013 datë 18.04.2013.

Të gjitha këto shetet e kanë të rregulluar institutin e posedimit dhe nuk kanë dallime substanciale mes tyre. Posedimi në Republikën e Maqedonisë Veriore është i rregulluar në mënyrë më të detajuar në 24 nene në raport me Republikën e Kosovës e cila institutin e posedimit e ka të rregulluar ne 11 nene dhe Republikën e Shqipërisë me 11 nene të cilat këtë institut e kanë të rregulluar në mënyrë më të përgjithësuar. Poashtu specifike e Republikës së Shqipërisë është afati i paraqitjes së padive posedimore, i cila afat është 6 muaj, nuk bënë dallimin mes afatit objektiv dhe subjektiv dhe është i paraparë në nenin 312, ndërsa në Republikën e Kosovës dhe Republikën e Maqedonisë Veriore afati për paraqitjen e padive posedimore është i paraparë si afat objektiv 1 vjeçar nga moment i pengimit apo zhveshjes së posedimit dhe afat 30 ditor si afat subjektiv, i cili fillon të rrjedhë nga moment i marrjes së dijenisë për pengimin apo zhveshjen e posedimit.

KAPITULLI III

1. Juridiksioni i Gjykatës Themelore Ferizaj dega në Kaçanik

Gjykata Themelore Ferizaj dega në Kaçanik është pjesë e Gjykatës Themelore në Ferizaj, e cila mbulon territorin e dy komunave – Komunës së Kaçanikut dhe atë të Hanit të Elezit⁶⁷ dhe në kuadër të sajë gjykon vetëm lëndët e departamentit të përgjithshëm, ku në këtë departament përfshihen edhe lëndët e natyrës civile⁶⁸

Komuna e Kaçanikut përfshin pjesën juglindore të Kosovës me sipërfaqe prej 211,13 km², përkatësisht 1,94 % të sipërfaqes së përgjithshme të Kosovës (10,887 km²). Komuna e Kaçanikut përbëhet prej 31 vendbanimeve, 1 me karakter urban dhe 30 rurale, ndërsa kufizohet me komunat e Vitisë, Ferizajt, Shtërpçës dhe në jug me Hani Elezit dhe Republikën e Maqedonisë Veriore⁶⁹ dhe ka 33409 banor.⁷⁰

Komuna e Hanit të Elezit ndodhet në pjesën juglindore të Kosovës afër kufirit me Republikën e Maqedonisë Veriore, ka një territor prej 83 km² dhe 9403 banor.⁷¹

2. Të dhënat statistikore

Të dhënat statistikore të hulumtimit të mbrojtjes së posedimit në juridiksionin e Gjykatës Themelore Ferizaj dega Kaçanik nga vitit 2013 deri më datë 2019, krahasimi dhe analizimi i tyre.

Pas përdorimit të të gjitha mjeteve dhe metodave për hulumtim rreth temës së këtij punimi të masterit dhe pas sigurimit të të gjitha të dhënave nga Gjykata Themelore në Ferizaj dega në

⁶⁷ Ligji nr. 06/l - 054 për Gjykatat, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 22 / 18 dhjetor 2018, Prishtinë, neni 10

⁶⁸ Edhe pse Komuna e Hanit të Elezit sipas Ligjit për Gjykatat ka degën e sajë, mirëpo dega e sajë ende nuk është bërë funksionale dhe deri në funksionimin e sajë, të gjitha lëndët e departamentit të përgjithshëm që përfshinë edhe lëndët civile gjykohen në Gjykatën Themelore Ferizaj dega në Kaçanik

⁶⁹ <https://kk.rks-gov.net/kacanik/qyteti/historiku/>

⁷⁰ <https://ask.rks-gov.net/media/2005/atllasi-i-regjistrimit-te-popullsise-2011.pdf>

⁷¹ <https://kk.rks-gov.net/haniielezit/qyteti/pozita-gjeografike/>

Kaçanik, pas analizimit të secilës lëndë veç e veç nga viti 2013 deri në vitin 2019, është arritur të sigurohet material i nevojshëm për ta përmbushur këtë punim dhe për t'i dhënë edhe më shumë kuptim dhe kahje të duhur.

Arkiva e gjykatës kishte një numër të caktuar me disa lëndë nga natyra e posedimit. Por edhe për shkak të numrit jo të madh të lëndëve të pranuara në gjykatë të natyrës së kontestve të posedimit, prapë se prap nuk ishte arritur të kryhen për çdo vjet lëndët e pranuara në punë.

Në vijim do të paraqiten statistikatat e lëndëve të pranuara, lëndëve të përfunduara dhe lëndëve të papërfunduara nga viti 2013-2019, po ashtu do të paraqiten në formë tabelare edhe të dhënat se sa paditës kanë qenë në një lëndë, sa të paditur, po ashtu do të paraqitet mënyra e vendosjes, ankesa dhe padyshim objekti i kontestit.

Për secilin vit kemi karakteristika të veçanta në disa vite ka pasur më shumë lëndë të pranuara në gjykatë, në disa të tjera më pak.

2.1. Lëndët e paraqitura në Gjykatën Themelore Ferizaj dega në Kaçanik për kontestet e posedimit gjatë vitit 2013

Gjatë vitit 2013 në Gjykatën Themelore Ferizaj-dega në Kaçanik lëndë të natyrës posedimore janë parashtruar 7 padi. Numri i paditësve për të gjithë këto padi ka qenë 10 paditës dhe të gjithë paditësit kanë qenë persona privat, ndërsa numri i të paditurve ka qenë 7 dhe 6 nga personat e paditur kanë qenë persona privat dhe 1 i paditur ka qenë institucion (Komuna e Kaçanikut). Objekt kontesti këtyre padive ka qenë: 5 padi kanë qenë të natyrës pengim posedimi në kalimin në rrugë, 1 padi ka qenë pengim posedimi nga ujërat e zaza dhe një padi ka qenë pengim i servitutit të kalimit në tokë bujqësore. Gjykata e shkallës së parë, lidhur me këto kërkesëpadi ka marrë vendime, për të cilat: 3 kërkesëpadi i ka aprovuar, 2 i ka refuzuar dhe për 2 lëndë paditësit i kanë tërhequr paditë.


Për mënyrën e vendosjes së këtyre lëndëve palët e pa kënaqura kanë ushtruar gjithësej 5 ankesa, 2 prej të cilave i kanë parashtruar palët paditëse dhe 3 ankesa i kanë parashtruar palët e paditura, të gjitha këto ankesa palët i kanë parashtruar brenda afatit ligjor për parashtrimin e ankesave. Gjykata e shkallës së dytë (Gjykata e Apelit) lidhur me këto ankesa ka marrë këto vendime: 2 prej ankesave së palës së paditur i ka vërtetuar aktvendimet e gjykatës së shkallës

së parë, 2 prej ankesave të palëve paditëse i ka kthyer në rigjykim dhe për 1 lëndë ende nuk ka vendosur.⁷²

Lëndët të cilat janë kthyer në rigjykim, me rastin e kthimit në gjykatën e shkallës së parë, sipas procedurave administrative për mirëmbajtjen dhe regjistrimin e lëndëve marrin numër të ri dhe si rrjedhojë këto lëndë regjistrohen në regjistrin dhe marrin numër përkatës në vitin në të cilin kthehen në rigjykim.⁷³

Në formë grafike prezntohen të dhënat e përshkruara më lartë:


2.1.1. Diagrami 1, viti 2013



⁷² Të gjitha këto të dhëna janë marrë në arkivën dhe evidencën e lëndë të Gjykatës Themelore Ferizaj dega në Kaçanik

⁷³ Ky sqarim do të vlejë për të gjitha vitet të cilat janë pjesë e këtij hulumtimi.

2.1.2. Diagrami 2, viti 2013



2.2. Lëndët e paraqitura në Gjykatën Themelore Ferizaj dega në Kaçanik për kontestet e posedimit gjatë vitit 2014


Gjatë vitit 2014 në Gjykatën Themelore Ferizaj dega në Kaçanik lëndë të natyrës posedimore janë parashtruar 5 padi. Numri i paditësve për të gjithë këto padi ka qenë 6 paditës dhe të 5 nga paditësit kanë qenë persona privat dhe një paditës person juridik (Terminali Doganor në Han të Elezit), ndërsa numri i të paditurve ka qenë 5 dhe 4 nga personat e paditur kanë qenë persona privat dhe 1 i paditur ka qenë institucion (Qeveria e Republikës së Kosovës). Objekt kontesti këtyre padive ka qenë: 3 padi kanë qenë të natyrës pengim posedimi në kalimin në rrugë, 1 padi ka qenë pengim posedimi nga ujërat e zeza dhe një padi ka qenë kthimi i posedimit të një pjese të një parcele malore. Gjykata e shkallës së parë, lidhur me këto kërkesëpadi ka marrë vendime, për të cilat: 4 kërkesëpadi i ka aprovuar, 1 e ka refuzuar

Për mënyrën e vendosjes së këtyre lëndëve palët e pa kënaqura kanë ushtruar gjithësej 5 ankesa, 1 prej të cilave e ka parashtruar pala paditëse dhe 4 ankesa i kanë parashtruar palët e paditura, të gjitha këto ankesa palët i kanë parashtruar brenda afatit ligjor për parashtrimin e ankesave. Gjykata e shkallës së dytë (Gjykata e Apelit) lidhur me këto ankesa ka marrë këto vendime: 2 prej aneksave së palës së paditur i ka vërtetuar aktvendimet e gjykatës së shkallës së parë, 1 prej ankesave të palëve paditëse e refuzuar ankesën dhe ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë, 1 lëndë e ka kthyer në rigjykim dhe për 1 lëndë ende nuk ka vendosur.⁷⁴

Gjatë vitit 2014 në raport me vitin 2013, sa i përket numrit të lëndëve kemi 2 lëndë më pak të parashtruara.


Në formë grafike prezantohen të dhënat e përshkruara më lartë:

2.2.1. Diagrami 1, viti 2014



⁷⁴ Të gjitha këto të dhëna janë marrë në arkivën dhe evidencën e lënde të Gjykatës Themelore Ferizaj dega në Kaçanik

2.2.2. Diagrami 2, viti 2014



2.3. Lëndët e paraqitura në Gjykatën Themelore Ferizaj dega në Kaçanik për kontestet e posedimit gjatë vitit 2015

Gjatë vitit 2015 në Gjykatën Themelore Ferizaj dega në Kaçanik lëndë të natyrës posedimore janë parashtruar 5 padi. Numri i paditësve për të gjithë këto padi ka qenë 5 paditës dhe të gjithë 5 nga paditësit kanë qenë persona privat, ndërsa numri i të paditurve ka qenë 6 dhe 4 nga personat e paditur kanë qenë persona privat dhe 2 të paditur kanë qenë institucion (Komuna e Kaçanikut). Objekt kontesti këtyre padive ka qenë: 4 padi kanë qenë të natyrës pengim posedimi në kalimin në rrugë, 1 padi ka qenë pengim posedimi nga ujërat e zeza. Gjykata e shkallës së parë, lidhur me këto kërkesëpadi ka marrë vendime, për të cilat: 2 kërkesëpadi i ka aprovuar, 2 i ka refuzuar dhe 1 është tërhequr paditësi nga padia.


Për mënyrën e vendosjes së këtyre lëndëve palët e pakënaqura kanë ushtruar gjithësej 4 ankesa, 2 prej të cilave e ka parashtruar pala paditëse dhe 2 ankesa i kanë parashtruar palët e paditura, të gjitha këto ankesa palët i kanë parashtruar brenda afatit ligjor për parashtrimin e

ankesave. Gjykata e shkallës së dytë (Gjykata e Apelit) lidhur me këto ankesa ka marrë këto vendime: 2 prej ankesave së palës paditëse i ka vërtetuar aktvendimet e gjykatës së shkallës së parë, 2 prej ankesave të palëve të paditur ende nuk ka vendosur.⁷⁵

Gjatë vitit 2015 në raport me vitin 2014, sa i përket numrit të lëndëve, kemi numër të njejtë të lëndëve të paraqitura.


Në formë grafike prezantohen të dhënat e përshkruara më lartë:

2.3.1. Diagrami 1, viti 2015



⁷⁵ Të gjitha këto të dhëna janë marrë në arkivën dhe evidencën e lënde të Gjykatës Themelore Ferizaj dega në Kaçanik

2.3.2. Diagrami 2, viti 2015



2.4. Lëndët e paraqitura në Gjykatën Themelore Ferizaj dega në Kaçanik për kontestet e posedimit gjatë vitit 2016

Gjatë vitit 2016 në Gjykatën Themelore Ferizaj dega në Kaçanik lëndë të natyrës posedimore janë parashtruar 8 padi. Numri i paditësve për të gjithë këto padi ka qenë 9 paditës dhe të gjithë paditësit kanë qenë persona privat, ndërsa numri i të paditurve ka qenë 8 dhe të gjithë personat e paditur kanë qenë persona privat. Objekt kontesti këtyre padive ka qenë: 6 padi kanë qenë të natyrës pengim posedimi në kalimin në rrugë, 2 padi ka qenë pengim posedimi nga ujërat zeza. Gjykata e shkallës së parë, lidhur me këto kërkesëpadi ka marrë vendime, për të cilat: 5 kërkesëpadi i ka aprovuar, 1 e ka refuzuar dhe 1 është tërhequr paditësi nga padia.


Për mënyrën e vendosjes së këtyre lëndëve palët e pakënaqura kanë ushtruar gjithësej 6 ankesa, 2 prej të cilave e ka parashtruar pala paditëse dhe 4 ankesa i kanë parashtruar palët e paditura, të gjitha këto ankesa palët i kanë parashtruar brenda afatit ligjor për parashtrimin e ankesave. Gjykata e shkallës së dytë (Gjykata e Apelit) lidhur me këto ankesa ka marrë këto vendime: 1 prej ankesës së palës paditëse i ka vërtetuar aktvendimet e gjykatës së shkallës së

pare dhe 1 e ka kthyer në rigjykim, 3 prej ankesave të palëve të paditur janë vërtetuar aktvendimet e gjykatës së shkallës së parë dhe për 1 lëndë ende nuk ka vendosur.⁷⁶

Gjatë vitit 2016 në raport me vitin 2015, sa i përket numrit të lëndëve, kemi 3 lëndë më shumë të paraqitura.


Në formë grafike prezantohen të dhënat e përshkruara më lartë:

2.4.1. Diagrami 1, viti 2016



⁷⁶ Të gjitha këto të dhëna janë marrë në arkivën dhe evidencën e lëndë të Gjykatës Themelore Ferizaj dega në Kaçanik

2.4.2. Diagrami 2, viti 2016



2.5. Lëndët e paraqitura në Gjykatën Themelore Ferizaj dega në Kaçanik për kontestet e posedimit gjatë vitit 2017

Gjatë vitit 2017 në Gjykatën Themelore Ferizaj dega në Kaçanik lëndë të natyrës posedimore janë parashtruar 6 padi. Numri i paditësve për të gjithë këto padi ka qenë 6 paditës dhe të gjithë paditësit kanë qenë persona privat, ndërsa numri i të paditurve ka qenë 7 dhe 6 nga personat e paditur kanë qenë persona privat, ndërsa 1 ka qenë institucion (Komuna e Kaçanikut). Objekt kontesti këtyre padive ka qenë: 6 padi kanë qenë të natyrës pengim posedimi në kalimin në rrugë. Gjykata e shkallës së parë, lidhur me këto kërkesëpadi ka marrë vendime, për të cilat: 2 kërkesëpadi i ka aprovuar, 1 e ka refuzuar, 2 janë tërhequr paditësit nga padia dhe 1 lëndë ende nuk është vendosur.


Për mënyrën e vendosjes së këtyre lëndëve palët e pakënaqura kanë ushtruar gjithësej 3 ankesa, 1 prej të cilave e ka parashtruar pala paditëse dhe 2 ankesa i kanë parashtruar palët e paditura, të gjitha këto ankesa palët i kanë parashtruar brenda afatit ligjor për parashtrimin e ankesave. Gjykata e shkallës së dytë (Gjykata e Apelit) lidhur me këto ankesa ka marrë këto vendime: 1 prej ankesës së palës paditëse i ka vërtetuar aktvendimet e gjykatës së shkallës së

parë, 1 prej ankesave të palëve të paditur është vërtetuar aktvendimet e gjykatës së shkallës së parë dhe për 1 lëndë ende nuk ka vendosur.⁷⁷

Gjatë vitit 2017 në raport me vitin 2016, sa i përket numrit të lëndëve, kemi 2 lëndë më pak të paraqitura.


Në formë grafike prezantohen të dhënat e përshkruara më lartë:

2.5.1. Diagrami 1, viti 2017



⁷⁷ Të gjitha këto të dhëna janë marrë në arkivën dhe evidencën e lëndë të Gjykatës Themelore Ferizaj dega në Kaçanik

2.5.2. Diagrami 2, viti 2017



2.6. Lëndët e paraqitura në Gjykatën Themelore Ferizaj dega në Kaçanik për kontestet e posedimit gjatë vitit 2018

Gjatë vitit 2018 në Gjykatën Themelore Ferizaj dega në Kaçanik lëndë të natyrës posedimore janë parashtruar 6 padi. Numri i paditësve për të gjithë këto padi ka qenë 6 paditës dhe të gjithë paditësit kanë qenë persona privat, ndërsa numri i të paditurve ka qenë 7, të gjithë personat e paditur kanë qenë persona privat. Objekt kontesti këtyre padive ka qenë: 4 padi kanë qenë të natyrës pengim posedimi në kalimin në rrugë dhe 2 kanë qenë pengim nga ujërat e zeza. Gjykata e shkallës së parë, lidhur me këto kërkesëpadi ka marrë vendime, për të cilat: 3 kërkesëpadi i ka aprovuar, 1 e ka refuzuar, 2 janë tërhequr paditësit nga padia


Për mënyrën e vendosjes së këtyre lëndëve palët e pakënaqura kanë ushtruar gjithësej 3 ankesa, të cilat ankesa i kanë parashtruar palët e paditura, të gjitha këto ankesa palët i kanë parashtruar brenda afatit ligjor për parashtrimin e ankesave. Gjykata e shkallës së dytë (Gjykata e Apelit) lidhur me këto ankesa ka marrë këto vendime: 1 prej ankesave të palëve të

paditur është vërtetuar aktvendimet e gjykatës së shkallës së parë dhe për 2 lëndë ende nuk ka vendosur.⁷⁸

Gjatë vitit 2018 në raport me vitin 2017, sa i përket numrit të lëndëve, ka pasur numër të njëjtë të lëndëve të paraqitura.


Në formë grafike prezantohen të dhënat e përshkruara më lartë:

2.6.1. Diagrami 1, viti 2018



⁷⁸ Të gjitha këto të dhëna janë marrë në arkivën dhe evidencën e lëndë të Gjykatës Themelore Ferizaj dega në Kaçanik

2.6.2. Diagrami 2, viti 2018



2.7. Lëndët e paraqitura në Gjykatën Themelore Ferizaj dega në Kaçanik për kontestet e posedimit gjatë vitit 2019

Gjatë vitit 2019 në Gjykatën Themelore Ferizaj dega në Kaçanik lëndë të natyrës posedimore janë parashtruar 9 padi. Numri i paditësve për të gjithë këto padi ka qenë 10 paditës dhe të gjithë paditësit kanë qenë persona privat, ndërsa numri i të paditurve ka qenë 9, dhe 8 nga personat e paditur kanë qenë persona privat, ndërsa 1 person juridik (KEDS). Objekt kontesti këtyre padive ka qenë: 6 padi kanë qenë të natyrës pengim posedimi në kalimin në rrugë, 1 ka qenë pengim nga ujërat e zeza dhe 1 pengim me përqes elektrik. Gjykata e shkallës së parë, lidhur me këto kërkesëpadi ende nuk ka vendosur.


Pasi që gjykata e shkallës së parë nuk ka vendosur për asnjë nga lëndët e parashtruara për vitin 2019, si rrjedhojë nuk ka të dhëna tjera.⁷⁹

Gjatë vitit 2019 në raport me vitin 2018, sa i përket numrit të lëndëve, ka pasur 3 lëndë të paraqitura më shumë.

⁷⁹ Të gjitha këto të dhëna janë marrë në arkivën dhe evidencën e lëndë të Gjykatës Themelore Ferizaj dega në Kaçanik

Në formë grafike prezantohen të dhënat e përshkruara më lartë:


2.7.1. Diagrami 1, viti 2019



3. Të dhënat e pasqyruara në diagramin më poshtë do të prezantojnë të gjitha rezultatet nga posedimi për periudhën e viteve 2013-2019

- Lëndët e pranuar me ngjyrë të kuqe
- Lëndët e përfunduara me ngjyrë të kaltërt
- Lëndët e papërfunduara me ngjyrë të zezë

3.1. Diagrami – Dinamika e lëndëve nga posedimi shkalla e parë



Nga ky përshkrim tabelar vërehet se nga viti në vit ka pasur ngritje dhe rënje të lëndëve të pranuar në Gjykatën Themelore Ferizaj -dega Kaçanik, kështu psh. në vitin 2013 janë pranuar 7 lëndë, ndërsa në vitin 2014 dhe në vitin 2015 janë pranuar nga vetëm 5 lëndë, atëherë shihet qartë se në viti 2013 kishe më shumë lëndë të kësaj natyre.⁸⁰

Siç edhe shihet nga diagrami i parë, në vitin 2016 ka ngritje të rastëve nga posedimi në gjithësej 8 lëndë.⁸¹

Por, nëse krahasojmë vitin 2016 me atë 2017 themi se në vitin 2017 ka pasur një rënje të vogël edhe atë janë pranuar 2 lëndë më pak sesa në vitin 2016.⁸² Në vitin 2017 për dallim nga vitet 2013, 14, 15. 16 kishte të pa përfundur vetëm 1 lëndë.

Viti 2018 ishte vit po i ngjajshëm me vitin 2017, pra edhe në vitin 2018 gjyqtari civilist kishte 6 lëndë nga posedimi në punë dhe sikurse që shihet në tabelë në çdo vit lëndët e tilla përfundoheshin nga ana e gjykatës, konkretisht gjyqtarit të çështjes.

⁸⁰ Raporti i lëndëve penale GJ.TH.F-dega Kaçanik për vitin 2013, 2014 dhe 2015.


⁸¹ Raporti i lëndëve penale GJ.TH.F-dega Kaçanik për vitin 2016.

⁸² Raporti i lëndëve penale GJ.TH.F-dega Kaçanik për vitin 2017.

Ndërsa nga të gjitha vitet është viti 2019 ku në këtë vit u pranuan 9 lëndë dhe dallimi mes vitit paraprak dhe atij 2019 konsiston në 3 lëndë të pranuar më shumë.⁸³ Dhe karakteristikë e vitit 2019 ishte se nuk ishte përfunduar asnjë nga lëndët.

Gjatë hulumtimit nuk është hasur në lëndë për të cilat ka pushuar procedura për shkak se paditë janë ushtruar pas afatit ligjor.


3.2. Diagrami nr. 2. Mënyra e vendosjes së lëndëve në shkallën e parë për periudhën 2013-2019



Gjatë periudhës kohore 2013 deri më 2019 në Gjykatën Themelore Ferizaj dega në Kaçanik janë parashtruar gjithësej 46 lëndë të natyrës posedimore, prej të cilave nga gjykata e shkallës së parë 19 janë aprovuar kërkesëpaditë e paditësve, 9 kërkesëpadi janë refuzuar, 8 padi janë tërhequr nga palët paditëse dhe 10 raste ende janë të pavendosura nga gjykata. Vlen të theksohet se për të gjithë këtë periudhë kohore nuk është hasur asnjë marrëveshje gjyqësore.


⁸³ Raporti i lëndëve penale GJ.TH.F-dega Kaçanik për vitin 2017.

3.3. Diagrami nr. 3. Mënyra e vendosjes së lëndëve në shkallën e dytë për periudhën 2013-2019



Gjatë periudhës kohore 2013 deri më 2019 në Gjyktën Themelore Ferizaj dega në Kaçanik janë parashtruar gjithësej 26 ankesa, prej të cilave nga gjykta e shkallës së dytë 14 vendime të shkallës së parë janë vërtetuar, 4 lëndë të shkallës së parë i janë kthyer gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe për 9 lëndë ende nuk ka vendosur gjykata e shkallës së dytë.

3.4. Diagrami nr. 4. Lëndët e parashtruara me objekt të kontestit për periudhën 2013-2019



Gjatë periudhës kohore 2013 deri më 2019 në Gjyktën Themelore Ferizaj dega në Kaçanik janë parshtruar 34 padi të natyrës së pengim posedimit të kalimit në rrugë, 8 padi janë parashtruar të natyrës së pengim posedimit nga lëshimi i ujërave të zeza, 1 padi është ushtruar e natyrës së pengim posedimit në tokë bujqësore, 1 në tokë malore dhe 1 pengim i posedimit nga vendosja e përquesit elektrik.

PËRFUNDIME

Pas përfundimit të këtij hulumtimi dhe analizimit të rasteve të natyrës posedimore në Gjykatën Themelore Ferizaj dega në Kaçanik për periudhën kohore 2013 – 2019 dhe pas nxjerrjes së përfundimeve lidhur me këtë hulumtim, duke u dhënë përgjigje edhe hipotezave të ngritura lidhur me këtë hulumtim: A gëzon mbrojtje juridike instituti i posedimit në Republikën e Kosovës?; Qytetarët a janë të vetedijshëm për të drejtat e tyre lidhur me posedimin?; Gjykatat a veprojnë në mënyrë të duhur në procedurat e mbrojtjes juridike të posedimit, me theks të veçantë Gjykata Themelore e Ferizajt, Dega në Kaçanik?, është arritur në këto përfundime:

Instituti i posedimit gëzon mbrojtje juridike në Republikën e Kosovës ku në aspektin procedural është e rregulluar me dispozitat e nenit 478-483 të Ligjit numër 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK), ndërsa në aspektin material është e rregulluar me Ligjin numër 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore, i cili me nenet 103-114 ka rregulluar se çka është posedimi, posedimi pronësor, bashkëposedimi, si fitohet posedimi, si shuhet posedimi etj.

Qytetarët nuk janë mjaftueshëm të vetëdijshëm për të drejtat e tyre lidhur me posedimin, këtë e bazojmë në faktin se në Gjykatën Themelore Ferizaj Dega në Kaçanik, gjatë një viti mesatarisht ushtron 300 lëndë të natyrave të ndryshme civile⁸⁴, ndërsa raste të natyrës posedimore ushtrohen një numër i vogël i rasteve⁸⁵. Gjatë hulumtimit është hasur se qytetarët nuk i kanë shfrytëzuar mundësitë ligjore për mbrojtjen e posedimit pasi që ka pasur numër të vogël të rasteve të paraqitura në gjykatë

Gjykatat, e posaçërisht Gjykata Themelore Ferizaj Dega në Kaçanik nuk i ka trajtuar me prioritet lëndët e natyrës posedimore dhe ka ngecje në trajtimin e këtyre rasteve nga ana e gjykatave si nga ajo e shkallës së parë për të cilën është bërë hulumtimi, e po ashtu edhe nga Gjykata e shkallës së dytë (Gjykata e Apelit të Kosovës).

REKOMANDIME

⁸⁴ Mesatarja e nxerrur nga të dhënat statistikore të Gjykatës Themelore Ferizaj dega në Kaçanik

⁸⁵ Të shikohen të dhënat statistikore për periudhën 2013 -2019 në këtë punim.

Instituti juridik i pengim posedimit edhe pse hyn në kuadër të procedurave të posaçme kontestimore dhe si rrjedhojë edhe afatet për konvokimin e senacave dhe zgjidhjen e rasteve janë më të shkurta, prap se prap me rastin e procedimit dhe vendosjes së këtyre rasteve nga ana e gjykatave duhet kushtuar vëmendje të veçantë dhe këto lëndë duhet për shkak të natyrës së tyre, të trajtohen në mënyrë dhe kohë sa më të shpejtë dhe të arsyeshme që mundet. Këtë e bazojmë edhe në faktin se në bazë të nenit 112 të Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore 0/L-154 ndaj personit i cili e shqetëson në posedim ose e ka marrë posedimin i njëjti ka të drejtë në vetëgjyqësi. Në qoftë se gjykatat veprojnë me shpejtësi dhe në kohë të arsyeshme do të bëhet e mundur që konfliktet mund të parandalohen apo minimizohen dhe në të njëjtën kohë do t'i ipet edhe zgjidhje juridike rasteve.

Kujdes të veçantë duhet kushtuar edhe kërkesave për masa siguruese, ku gjykata me rastin e vendosjes për të njëjtat duhet të kenë parasysh që vendimet për masa siguruese mos të jenë të njëjta sikur kërkesëpadi, apo masa siguruese mos ta zgjidh çështjen kryesore, por vetëm të ketë karakter siguruese deri në vendosjen e kërkesës kryesore.

Lidhur më këto gjetje i rekomandojmë gjykatave që kontestet e natyrës së posedimit t'i trajtoj në kohë sa më të shkurtër të mundshëm duke i aplikuar në tërësi diaspozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore, në të cilin ky institut hy në kuadër të procedurave të veçanta ku parashihen edhe afatet me të shkurtra për të vendosur për këto raste. Ky rekomandim është i lidhur edhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut ku në nenin 6 thuhet *“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile.....”*.

Po ashtu u rekomandohet qytetarëve dhe juristëve të cilët i këshillojnë ato që t'i përdorin këto mundësi ligjore dhe të parashitjnë padi posedimore për mbrojtjen e të drejtave të tyre nga posedimi, ky rekomandim bazohet në faktin që është cekur më lartë se instituti i posedimit hynë në kuadër të procedurave të veçanta ku parashihen edhe afatet me të shkurtra për të vendosur për këto raste, gjykata po ashtu nuk lëshohet në shqyrtimin e çështjes kryesore apo ligjshmërisë së posedimit, por vetëm konstaton gjendjen e fundit të posedimit dhe duke krahasuar me procedura apo padi të llojit tjetër si padi për vërtetim pronësie apo padi për lirim të paluajtshmërisë etj, këto raste janë më të komplikuar në krahasim me rastet posedimore dhe nevojitet seanca më të shumta, dëshmi më të shumta, ekzpertiza më të shumta dhe zgjidhja e rastit merr kohë shumë më të madhe.

BIBLIOGRAFIA

Libra dhe punime shkencore:

- Brestovci Faik, E Drejta Procedurale Civile II, Prishtinë, 2006
- Sulejmani Shukri, E Drejta Civile, Akademia e Drejtësisë, Prishtinë, Tetor 2017
- Ademaj Qerim; Rexhepi Fejzullah: Mbrojtja Gjyqësore nga Pengim Posedimi dhe Servitutet, Prishtinë Shkurt 2018
- Morina Iset, Nikqi Selim; Komentari i Ligjit për Procedurën Kontestimore, Prishtinë, Dhjetor 2012
- Haxhibeqiri Erdogan, E Drejta e Pronësisë dhe të Drejta tjera të Përafërta, Akademia e Drejtësisë, Prishtinë, Tetor 2017
- Dr. Puan I.- E Drejta Romake, Botim i Entit të Tekstëve dhe Mjeteve Mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë, Dhjetor 1968
- Gams Andrija; Bazat e së Drejtës Reale, Prishtinë, 1972
- Gjeçovi Shtjefën, Kanuni i Lekë Dukagjijit, Shkodër 1933
- Shkurti Altin, Posedimi dhe Mbrojtja e tij, Tiranë 2015
- Aliu Abdulla: E drejta sendore, Prishtinë 2006
- Aliu Abdulla: E drejta sendore, Prishtinë 2014
- Aliu Abdulla: E drejta Civile, Prishtinë 2013
- Zendeli Emine, Zendeli Nagip. E drejta procedurale civile - E drejta kontestimore. Faculty of Law, South East European University-Tetovo, Macedonia, Skopje, Macedonia, 4 / 2011. ISBN 978-608-4503-52-1.
- Nuni A & Hasneziri L, 'Leksione të së drejtës së pronësisë' Tiranë 2007.
- Kondili V., E drejta Civile II, Pjesa e posaçme, Pronësia, të drejtat reale të përkohëshme dhe trashëgimia, Shtypshkronja Geer, 2008,
- Charles P. Sherman, Yale Law School, Acquisitive Prescription: Its Existing World-Wide Uniformity, Yale Law School,
- Clarke A. & Kohler P. Property Law: Commentary and Materials (CUP, Cambridge 2009)
- Gray Kevin & Gray Susan F., Elements of Land (5th ed 2009), Oxford University Press, ISBN 978-0-19-921972-8

Akte Juridike:

- Ligjin për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore numër 03/L-154 publikuar Gazetën Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: viti iv / nr. 57 / 04.08.2009
- Ligji për Procedurën Përmbartimore numër 04/L-139 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 3 / 31.01.2013, Prishtinë
- Ligji nr. 06/l - 054 për Gjykatat, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 22 / 18.12.2018, Prishtinë
- Ligji mbi Marrëdhëniet Themelore Juridiko Pronësore, Kuvendi i RSFJ, në seancën e Dhomës Federative datë 30 janar 1980, me numër 827
- Ligjin për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore “Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 18 të datës 05.03.2001 në nenet 167 deri 191
- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.7850 të datës 29.07.1994, ndryshuar me ligjet 8536, datë 18.10.1996, 8781 datë 03.05.2001, 17/2012 datë 16.02.2012, 121/2013 datë 18.04.2013
- Ligji Nr. 03/L-006 Për Procedurën Kontestimore, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: Viti Iii / Nr. 38 / 20 Shtator 2008
- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Burime tjera:

- <https://kk.rks-gov.net/kacanik/qyteti/historiku/>
- <https://kk.rks-gov.net/haniielezit/qyteti/pozita-gjeografike/>
- <https://ask.rks-gov.net/media/2005/atllasi-i-regjistrimit-te-popullsise-2011.pdf>
- <http://jus.igjk.rks-gov.net/>
- https://adelearning.rks-gov.net/ilias/goto.php?target=root_1&client_id=kjikosovo